

LIGJ
Nr. 18/2018

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË 5 TË MARRËVESHJES PËR
AMENDIMIN DHE ADERIMIN NË MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË TË
EVROPËS QENDRORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin shtesë 5 i marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.4.2018

Shpallur me dekretin nr. 10770, datë 23.4.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DRAFT PËRFUNDIMTAR 1.11.2016
PROTOKOLL SHITESË 5
I MARRËVESHJES PËR AMENDIMIN DHE ADERIMIN NË MARRËVESHJEN
E TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE

Preambul

Duke pasur parasysh konkluzionet e Këshillit Ministror më 21 nëntor 2014, mbi theksin e vënë për rëndësinë e ndërmarrjes së përpjekjeve që synojnë thellimin e zbatimit të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (më poshtë e referuar si “CEFTA 2006”) dhe duke pasur parasysh dispozitat e neneve 12, 13 dhe 14(4) të CEFTA 2006;

duke vendosur të eliminojnë barrierat në tregtinë e tyre të ndërsjellë, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Marrakeshit, e cila themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë (më poshtë e referuar si “OBT”) dhe për të vendosur gradualisht marrëdhënie më të ngushta tregtare;

duke vendosur të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të ndërsjella tregtare, në përputhje me rregullat dhe disiplinat e OBT-së, qofshin ose jo anëtarë të OBT-së;

duke marrë parasysh plotësisht rëndësinë e kontributit pozitiv të lehtësimit të tregtisë në zhvillimin ekonomik;

duke theksuar rolin e procesit të përafrimit me BE-në për të nxitur njohjen reciproke të programeve, dokumenteve dhe inspektimeve ndërmjet Palëve të CEFTA-s, të parashikuara nga ky Protokoll Shtesë 5 (më poshtë i referuar si “Protokolli”);

duke pasur parasysh se asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohet se përjashton Palët e CEFTA-s nga detyrimet e tyre, sipas marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, veçanërisht me OBT-në;

duke vendosur të forcojnë marrëdhëniet tregtare-ekonomike dhe mirëkuptimin e ndërsjellë ndërmjet

Palëve të CEFTA-s;

duke pranuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe përpjekjet për zgjerimin e bashkëpunimit rajonal;

duke pasur parasysh se Palët e CEFTA-s janë të vendosura për të përmirësuar sigurinë në tregtinë e mallrave që hyjnë ose dalin nga territoret e tyre, pa penguar qarkullimin tregtar;

duke përkujtuar për të lehtësuar zhvillimin e tregtisë përmes futjes së formave dhe metodave moderne të inspektimit;

duke pranuar nevojën për të shkëmbyer të dhëna përmes përdorimit të instrumenteve elektronike, me qëllim forcimin dhe përmirësimin e cilësisë së analizës së riskut nga Palët e CEFTA-s;

duke theksuar nevojën për investime në teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit për të lehtësuar shkëmbimin elektronik të dokumenteve ndërmjet Palëve të CEFTA-s, siç kërkohet nga ky Protokoll;

duke theksuar rëndësinë e shqyrtimit të plotë që duhet ndërmarrë nga secila Palë e CEFTA-s e cila konfirmon gatishmërinë e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për zbatimin e dispozitave të këtij Protokollit, i cili kërkon shkëmbimin elektronik të të dhënave në nivel kombëtar;

duke shprehur gatishmërinë e Palëve të CEFTA-s për të bashkëpunuar me Bashkimin Evropian dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë të gatshëm për të bashkëfinancuar investimet e nevojshme për plotësimin e nevojave të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të Palëve të CEFTA-s për zbatimin e Protokollit; dhe

duke pasur parasysh se Palët e CEFTA-s kanë nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave,

Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s, në prani të të gjitha Palëve të CEFTA-s, ka rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllime të këtij Protokollit:

a) “Të dhëna” nënkupton të gjitha të dhënat, nëse janë apo jo të përpunuara ose të analizuar dhe dokumentet, raportet dhe komunikime të tjera në çdo format, duke përfshirë kopjet elektronike, të certifikuar ose të vërtetuara të tyre;

b) “Inspektim” nënkupton çdo operacion përmes të cilit autoritetet doganore ose ndonjë autoritet tjetër inspektimi apo kontrolli kryen ekzaminimin fizik ose inspektimin vizual të mjeteve të transportit ose të vetë mallrave për të siguruar se natyra, origjina, gjendja, shëndeti, siguria, sasia dhe vlera e tyre janë në përputhje me të dhënat që gjenden në dokumentet e prodhuara;

c) “Formalitete” nënkupton çdo formalitet të cilit i nënshtrohet një operator nga autoritetet dhe i cili konsiston në prodhimin ose shqyrtimin e dokumenteve, certifikatave që shoqërojnë mallrat ose të dhëna të tjera të hollësishme, pavarësisht nga metoda apo mjeti i përdorur në lidhje me mallrat ose mjetet e transportit;

d) “Risk” nënkupton mundësitë e ndodhjes së një ngjarjeje në lidhje me hyrjen, daljen, transitin, transferimin dhe përdorimin final të mallrave që lëvizin ndërmjet territoreve doganore të Palëve të CEFTA-s dhe ndërmjet territoreve doganore të një prej Palëve të CEFTA-s dhe vendeve të treta, si dhe prania e mallrave që nuk janë në qarkullim të lirë në territorin e një prej Palëve të CEFTA-s, gjë që vë në rrezik sigurinë e Palëve të CEFTA-s, mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve, bimëve dhe mjedisit;

e) “Menaxhim i riskut” nënkupton identifikimin sistematik të riskut dhe zbatimin e të gjitha masave të nevojshme për të kufizuar ekspozimin ndaj riskut. Kjo përfshin aktivitetet, të tilla si: mbledhja e të dhënave dhe informacioneve, analizimi dhe vlerësimi i riskut, përcaktimi dhe marrja e masave, si dhe monitorimi i rregullt dhe rishikimi i procesit dhe rezultateve të tij, bazuar në burimet dhe strategjitë e përcaktuara nga palët e CEFTA-s, në nivel kombëtar, rajonal apo ndërkombëtar;

f) “Vlerësim i riskut për të dhënat e mbërritjes paraprake të mallrave” nënkupton analizën e riskut dhe aktivitetet të tjera analitike duke përdorur të dhënat e dërguara nga Pala e CEFTA-s që kryen eksportin, kur dokumenti përkatës është pranuar në sistemin e teknologjisë së informacionit të autoritetit përkatës të Palës së CEFTA-s që kryen importin, si dhe të dhënat për mallrat transit;

g) “Operatorë ekonomikë të autorizuar” nënkupton operatorin ekonomik të krijuar në një prej Palëve të CEFTA-s, i cili çmohet i besueshëm në kuadrin e operacioneve që lidhen me doganat dhe që për këtë arsye ka të drejtë të gëzojë përfitime në një ose më shumë Palëve të CEFTA-s; dhe

h) “Kufi” nënkupton çdo pikë kalimi ku mallrat hyjnë dhe/ose dalin nga territori doganor i një Pale të CEFTA-s.

Neni 2 Objektivi

2.1. Pa cenuar dispozitat e veçanta në fuqi sipas akteve ligjore të lidhura ndërmjet Palëve të CEFTA-s, ky Protokoll zbatohet për thjeshtimin e inspektimeve, reduktimin e formaliteteve në masën maksimale të mundshme, shkëmbimin e të dhënave në lidhje me transportin e mallrave ndërmjet Palëve të CEFTA-s dhe bashkëpunimin e programeve për partneritet tregtar.

2.2. Ky Protokoll nuk zbatohet për inspektimet apo formalitetet në lidhje me anijet dhe avionët si mjete transporti. Sidoqoftë, Protokollin zbatohet për automjetet dhe mallrat e transportuara nga mjetet e mësipërme të transportit.

2.3. Aktivitetet e ndërmarra nga palët e CEFTA-s për qëllimet e zbatimit të këtij Protokollin do të jenë në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni 3 Objektivi i përgjithshëm

Në përputhje me këtë Protokoll dhe anekset e tij, të cilat janë pjesë përbërëse e Protokollit, Palët e CEFTA-s:

1. Thjeshtojnë inspektimet në lidhje me të gjitha procedurat e zhdoganimit dhe reduktojnë formalitetet në masën maksimale të mundshme;
2. Shkëmbejnë të dhëna midis autoriteteve doganore në masën që lejon çdo legjislacion kombëtar;
3. Njohin reciprokisht programet kombëtare të operatorëve ekonomikë të autorizuar në çdo Palë të CEFTA-s, me kusht që legjislacioni dhe zbatimi i çdo programi kombëtar të jenë në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës të BE-së.

Neni 4 Zgjerimi i objektivit

4.1. Për t'i shërbyer objektivit të përgjithshëm të lehtësimit të tregtisë dhe sigurisë parandaluese, dhe kontroleve që lidhen me sigurinë, Palët e CEFTA-s mund të zgjerojnë objektin e të dhënave të shkëmbyera në mënyrë elektronike me qëllim përfshirjen më shumë të autoriteteve të tjera, se sa autoriteteve doganore, në shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe mund të forcojnë bashkëpunimin ndërmjet kufirit të tyre dhe agjencive të tjera të kontrollit në lidhje me sa më poshtë:

- a) Përafrimi i orëve dhe ditëve të punës;
- b) Përafrimi i procedurave dhe i formaliteteve;
- c) Krijimi dhe ndarja e objekteve të përbashkëta;
- d) Kontrollin e përbashkët; dhe
- e) Krijimi i kontrollit kufitar *one stop* (me një ndalesë).

4.2. Për të lehtësuar tregtinë rajonale përmes thjeshtimit të procedurave doganore dhe procedurave të tjera të ngjashme për zhdoganimin e mallrave dhe për të reduktuar formalitetet e zhdoganimit, të dhënat shkëmbehen midis Palëve të CEFTA-s në momentin para mbërritjes së mallrave.

4.3. Palët e CEFTA-s shkëmbejnë të dhënat që përmbajnë të dhënat doganore, dokumentet shoqëruese të certifikatave dhe deklaratat doganore dhe çdo informacion tjetër përkatës që kërkohet për zhdoganimin e mallrave.

Neni 5 Menaxhimi i riskut

5.1. Palët e CEFTA-s shkëmbejnë të dhëna nëpërmjet instrumenteve elektronike, me qëllim:

- a) Forcimin dhe përmirësimin e cilësisë së analizës së tyre të riskut dhe efektivitetin e kontroleve që lidhen me sigurinë;
- b) Krijimin e një kornize të përbashkët për menaxhimin e riskut, për kriteret e përbashkëta të riskut dhe zonat e kontrollit me prioritet të përbashkët për CEFTA-n në nivel rajonal; dhe
- c) Ngritjen e një sistemi elektronik për të zbatuar menaxhimin e riskut të përbashkët midis Palëve të CEFTA-s.

5.2. Secila Palë e CEFTA-s miraton ose ruan një sistem të menaxhimit të riskut për inspektim nga të gjitha autoritetet kompetente në të gjitha fazat e zhdoganimit. Shqyrtimi i gjendjes aktuale raportohet çdo vit pranë Komitetit të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë.

5.3. Secila Palë e CEFTA-s harton dhe zbaton sistemin për menaxhimin e riskut, me qëllim shmangien e

diskriminimit arbitrar ose të pajustificueshëm midis Palëve të CEFTA-s ku mbizotërojnë të njëjtat kushte ose kufizimit të fshehur në tregti ndërmjet Palëve të CEFTA-s.

5.4. Secila Palë e CEFTA-s përqendron kontrollin doganor dhe, në masën e mundshme, kontrollin e tjera përkatëse kufitare, në dërgesat me risk të lartë dhe përshpejton lejimin e dërgesave me risk të ulët. Një Palë e CEFTA-s mund të zgjedhë, gjithashtu, në mënyrë të rastësishme, dërgesa për kontrolle të tilla si pjesë e menaxhimit të saj të riskut.

5.5. Secila Palë e CEFTA-s e mbështet menaxhimin e riskut në vlerësimin e riskut nëpërmjet kriterëve të përshtatshme të përzgjedhjes. Kriteret e tilla përzgjedhjeje mund të përfshijnë, ndër të tjera, sistemin e harmonizuar, natyrën dhe përshkrimin e mallrave, vendin e origjinës, vendin nga i cili janë transportuar mallrat, vlerën e mallrave, regjistrimin e përputhshmërisë së tregtarëve, si dhe llojin e mjeteve të transportit.

5.6. Palët e CEFTA-s shkëmbejnë, në masën maksimale të mundshme, të dhëna statistikore në lidhje me ecurinë e zbatimit të analizës së tyre të riskut dhe rezultatet e inspektimeve të tyre dhe kriteret e përzgjedhjes në zhdoganimin e mallrave.

5.7. Secila Palë e CEFTA-s konfirmon me Palët e tjera të CEFTA-s, nëpërmjet komunikimit me shkrim drejtuar Komitetit të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë, jo më vonë se tre vjet pasi ky Protokoll hyn në fuqi, informacionet në vijim:

a) Që autoritetet kompetente, të cilat janë përfshirë në zhdoganimin e mallrave, kanë një ekip ose njësi funksionale të ngarkuar me projektimin, rishikimin e rregullt dhe përditësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut;

b) Pikat e kontaktit, në kuadrin e çdo autoriteti kompetent që është përgjegjës për menaxhimin e riskut; dhe

c) Sistemet e përbashkëta ose të pajtueshme për të gjithë territorin e tyre doganor.

5.8. Palët e CEFTA-s janë nxitur të miratojnë procedura që lejojnë komunikimin e riskut midis Palëve të CEFTA-s, përmes të cilit autoritetet kompetente që janë përfshirë në zhdoganimin e mallrave mund të shkëmbejnë informacione në lidhje me riskun.

Neni 6

Njoftimet për rritjen e kontrolleve ose inspektimeve

6.1. Kur një Palë e CEFTA-s miraton ose ruan një sistem për lëshimin e njoftimeve ose të udhëzimeve pranë autoriteteve të saj kompetente të përfshira në zhdoganimin e mallrave, për qëllime të rritjes së nivelit të kontrolleve ose inspektimeve në kufi për ushqimet, pijet apo ushqimet për kafshët që përmban njoftimi apo udhëzuesi për mbrojtjen e jetës ose të shëndetit të njerëzve, të kafshëve apo të bimëve, brenda territorit të saj zbatohen disiplinat në vijim për lëshimin, ndërprerjen apo pezullimin e tyre:

a) Njoftimi apo udhëzuesi i bazuar në risk mund të nxirret, sipas rastit;

b) Njoftimi apo udhëzimi mund të nxirret, me qëllim që të zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme vetëm për ato pika të hyrjes ku zbatohen kushtet sanitare dhe fitosanitare në të cilat bazohet njoftimi ose udhëzuesi;

c) Njoftimi ose udhëzimi ndërpritet menjëherë, kur rrethanat që e krijojnë atë nuk ekzistojnë më ose nëse rrethanat e ndryshuara mund të trajtohen në një mënyrë më pak treg-kufizuese; dhe

d) Njoftimi ose udhëzimi, kur është marrë vendimi për përfundimin apo pezullimin e tij, do të publikohet menjëherë. Shpallja e përfundimit ose e pezullimit bëhet në mënyrë jodiskriminuese dhe lehtësisht të aksesueshme, ose informacioni i jepet Palës eksportuese të CEFTA-s apo operatorit ekonomik.

6.2 Të gjitha njoftimet e parashikuara në këtë paragraf do të vihen në dispozicion në faqen e internetit të autoriteteve kompetente të Palëve të CEFTA-s që lëshojnë njoftimet. Secila palë e EFTA-s do të vërë në dispozicion, në gjuhën e vet kombëtare dhe në anglisht, një listë ku përcaktohet se cili informacion dhe/ose njoftim do të komunikohet në cilën faqe të internetit të administratave të tyre. E njëjta listë do të publikohet në *Transparency Pack* të CEFTA-s.

6.3. Pala e CEFTA-s informon menjëherë transportuesin ose importuesin në rastin e ndalimit të mallrave të deklaruar për import, për inspektim nga autoritetet doganore apo ndonjë autoritet tjetër kompetent.

6.4. Një Palë e CEFTA-s mund të japë, sipas kërkesës, mundësi për një test të dytë në rastin kur rezultati i testit të parë të një mostre, të marrë nga autoriteti kompetent pas mbërritjes së mallrave të deklaruar për import, tregon një gjetje negative.

6.5. Një Palë e CEFTA-s publikon në mënyrë jodiskriminuese dhe lehtësisht të aksesueshme, emrin dhe adresën e çdo laboratorit ku mund të kryhet testi ose i siguron këtë informacion importuesit, kur jepet mundësia, e parashikuar sipas paragrafit 6.4.

6.6. Një Palë e CEFTA-s merr parasysh rezultatin e testit të dytë, nëse ka ndonjë, të kryer sipas paragrafit 6.4, për çlirimin dhe për zhdoganimin e mallrave dhe, nëse është e përshtatshme, do të pranojë rezultatet e një

testimi të tillë.

Neni 7

Publikimi i tarifave dhe i taksave të vendosura për ose në lidhje me importimin, eksportimin dhe gjrobat

7.1. Dispozitat e këtij neni zbatohen për të gjitha tarifatat dhe taksat, përveç detyrimeve të importit dhe eksportit dhe përveç taksave në kuadër të fushës së veprimit të nenit III, të GATT 1994, vendosur nga Palët e CEFTA-s apo në lidhje me importimin ose eksportimin e mallrave.

7.2. Informacioni për tarifatat dhe taksat do të vihet në dispozicion në rrugë elektronike nga autoritetet kompetente të secilës Palë të CEFTA-s dhe do të publikohet në pajtim me nenin 1 të Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Tregtisë. Ky informacion përfshin tarifatat dhe taksat që do të zbatohen, arsyen e caktimit të tarifave dhe taksave të tilla, autoritetin përgjegjës, si dhe faktin kur dhe si duhet të bëhet pagesa.

7.3. Në zbatim të këtij neni, publikimet e të gjitha tarifave dhe taksave, duke përfshirë të gjitha detajet e specifikuar në paragrafin 7.2, do të vihen në dispozicion në gjuhën kombëtare të Palës së CEFTA-s që nxjerr publikimet dhe në gjuhën angleze.

7.4. Të gjitha publikimet në lidhje me tarifatat dhe taksat, parashikuar në paragrafin 7.2, do të vihen në dispozicion në rrugë elektronike në faqen e internetit të autoriteteve përkatëse kompetente të Palëve të CEFTA-s. Secila Palë e CEFTA-s vë në dispozicion të *Transparency Pack* të CEFTA-s një listë të vetme, në gjuhën e vet kombëtare dhe në gjuhën angleze, duke identifikuar dhe duke hartuar në mënyrë shteruese të gjitha tarifatat dhe taksat, arsyet e caktimit të tarifave dhe taksave të tilla, autoritetin kompetent, si dhe informacion se kur dhe si duhet të bëhet pagesa. Këto lista të vetme të ofruara nga Palët e CEFTA-s rishikohen çdo vit dhe përditësohen menjëherë nga Pala përkatëse e CEFTA-s pas ndryshimit të kryer në përbërjen e këtyre listave të vetme.

7.5. Nuk zbatohen tarifa apo taksa të reja ose të ndryshuara para se të ketë kaluar një periudhë e mjaftueshme që prej botimit të tyre, me përjashtim të rrethanave urgjente. Palët e CEFTA-s do të sigurojnë që legjislacioni i tyre për tarifatat dhe taksat e reja do të jetë i disponueshëm në përputhje me paragrafin 7.3. Në rast urgjence, Pala e CEFTA-s duhet të informojë Komitetin e CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë, me shkrim, mbi datën e hyrjes në fuqi të tarifave dhe taksave të reja ose të ndryshuara, si dhe arsyet për masa urgjente.

7.6. Secila Palë e CEFTA-s rishikon periodikisht tarifatat dhe taksat me qëllim reduktimin e numrit dhe diversitetit të tyre, kur është e zbatueshme. Këto rishikime periodike bëhen çdo vit nga Palët e CEFTA-s. Raportet e rishikimeve vjetore i paraqiten Komitetit të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë nga secila Palë e CEFTA-s. Raportet e para të rishikimit do të paraqiten në takimin e parë të Komitetit të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë të mbajtur një vit pas datës së hyrjes në fuqi të Protokollit.

7.7. Tarifatat dhe taksat për përpunim doganor:

a) Do të jenë të kufizuara në shumën për koston e përafërt të shërbimeve të kryera në lidhje me operacionin e veçantë të importit dhe eksportit në fjalë; dhe

b) Nuk kërkohet të jenë të lidhura me një operacion të veçantë importi ose eksporti, me kusht që ato të jenë vënë për shërbime që janë të lidhura ngushtë me përpunimin doganor të mallrave.

7.8. Për qëllime të paragrafëve 9 deri 15, termi “gjoba” do të thotë gjobat e vendosura nga administrata doganore e një Pale të CEFTA-s apo organe të tjera kompetente përgjegjëse për zhdoganimin e mallrave të importuara/eksportuara ose mallrave transit, si pasojë e shkeljes së ligjeve doganore, rregullave ose kërkesave procedurale të Palës së CEFTA-s ose të ligjeve, rregullave apo kërkesave të tjera procedurale të zbatueshme për importet, eksportet dhe transitin.

7.9. Secila Palë e CEFTA-s siguron se ligjet doganore, rregullat ose kërkesat procedurale të Palës së CEFTA-s, për shkeljen e ligjeve doganore ose ligjet, rregullat apo kërkesat e tjera procedurale të zbatueshme për importet, eksportet dhe transitin, janë vendosur vetëm për personin (personat) përgjegjës për shkeljen sipas ligjeve të saj.

7.10. Vënia e gjobës varet nga faktet dhe rrethanat e çështjes dhe duhet të jetë proporcionale me shkallën dhe ashpërsinë e shkeljes.

7.11. Secila Palë e CEFTA-s siguron për vënien në zbatim të masave për të shmangur:

a) Konfliktet e interesit në vlerësimin dhe mbledhjen e gjobave dhe detyrimeve; dhe

b) Krijimin e një stimuli për vlerësimin ose mbledhjen e gjobave që janë në kundërshtim me paragrafin 7.8.

7.12. Secila Palë e CEFTA-s siguron se, kur një gjobë vendoset për shkelje të ligjeve doganore, rregullave ose kërkesave procedurale apo për shkelje të të gjitha ligjeve, rregullave ose kërkesave procedurale të zbatueshme për importet, eksportet dhe transitin, atëherë jepet një shpjegim me shkrim për personin

(personat) ndaj të cilit është vendosur gjoba duke specifikuar natyrën e shkeljes dhe ligjin e zbatueshëm, rregulloren ose procedurën sipas së cilës është parashikuar shuma ose masa e gjobave për shkeljen e kryer.

7.13. Kur një person i zbulon vullnetarisht administratës doganore të një Pale të CEFTA-s rrethanat e një shkeljeje të së drejtës doganore, rregullores ose kërkesave procedurale apo ndonjë agjencie tjetër rrethanat e një shkeljeje të së drejtës doganore, rregullores ose kërkesave procedurale të zbatueshme për importet, eksportet dhe transitin para zbulimit të shkeljes nga administrata doganore apo agjenci të tjera, Pala e CEFTA-s nxitet, sipas rastit, ta konsiderojë këtë fakt si një faktor të mundshëm lehtësues kur vendos një dënim të caktuar për atë person.

7.14. Dispozitat e këtij paragrafi zbatohen për dënimet mbi lëvizjet transit të përmendur në paragrafin 7.1.

7.15. Secila Palë e CEFTA-s siguron që çdo person, ndaj të cilit autoritetet doganore ose autoritete të tjera kompetente përgjegjëse për zhdoganimin e mallrave kanë dhënë një vendim administrativ, ka të drejtë, brenda territorit të saj, të:

a) Depozitojë një ankesë administrative për shqyrtim nga një autoritet administrativ më i lartë apo i pavarur se nëpunësi apo zyra që ka dhënë vendimin; dhe/ose

b) Depozitojë një ankesë gjyqësore ose kërkesë për rishikimin e këtij vendimi.

Neni 8

Formalitetet që lidhen me importimin, eksportimin dhe transitin

8.1. Me qëllim minimizimit të incidencës dhe kompleksitetit të formaliteteve të importit, eksportit dhe transitit, si dhe uljen dhe thjeshtësimin e kërkesave të dokumentacionit të importit, eksportit dhe transitit, duke marrë parasysh objektivat legjitimë politike dhe faktorë të tjerë, të tillë si: ndryshimi i rrethanave, informacionet e reja përkatëse, praktikat e biznesit, disponueshmërinë e teknikave dhe teknologjisë, praktikat më të mira ndërkombëtare, komentet nga palët e interesuara, secila Palë e CEFTA-s shqyrton kërkesat e formaliteteve dhe dokumentacionit dhe, bazuar në rezultatet e shqyrtimit të bërë, siguron, sipas rastit, se kërkesat të tilla të formaliteteve dhe dokumentacionit janë:

a) Miratuar dhe/ose zbatuar, me qëllim çlirimin dhe zhdoganimin e shpejtë të mallrave, veçanërisht të mallrave që prishen shpejt;

b) Miratuar dhe/ose zbatuar në një mënyrë të tillë që synon uljen e kohës dhe kostos së përpunshmërisë për tregtarët dhe operatorët;

c) Masa më pak treg-kufizuese të zgjedhura, ku dy ose më shumë masa alternative janë të disponueshme për përmbushjen e objektivit apo objektivave të politikave në fjalë; dhe

d) Nuk ruhen, duke përfshirë pjesë të tyre, nëse nuk kërkohen më.

8.2. Palët e CEFTA-s shqyrtojnë kërkesat për formalitetet dhe dokumentacionin lidhur me importimin, eksportimin dhe transitin jo më vonë se një vit pasi ky Protokoll hyn në fuqi. Pas përfundimit të shqyrtimit të parë, shqyrtimet e tjera bëhen çdo dy vjet. Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s harton procedurat për shqyrtimet dhe për shkëmbimin e informacioneve përkatëse dhe praktikave më të mira nga Palët e CEFTA-s, sipas rastit, brenda gjashtë muajve pasi ky Protokoll hyn në fuqi.

8.3. Secila Palë e CEFTA-s, sipas rastit, duhet të përpiqet që të pranojë kopje fizike ose elektronike të dokumenteve mbështetëse që kërkohen për formalitetet e importit, eksportit ose transitit nga autoritetet doganore dhe autoritete të tjera kompetente.

8.4. Kur autoriteti kompetent i Palës së CEFTA-s mban kopjen origjinale të dokumenteve të tilla, çdo autoritet tjetër kompetent i kësaj Pale të CEFTA-s pranon kopje fizike ose elektronike të dokumenteve origjinale, sipas rastit, nga autoriteti kompetent që ka origjinalin. Secila Palë e CEFTA-s konfirmon se janë nënshkruar memorandumet e mirëkuptimit midis autoriteteve të tyre kompetente, për të siguruar pranimin e ndërsjellë të kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve ndërmjet autoriteteve kompetente, siç kërkohet në këtë paragraf. Konfirmimi në lidhje me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit i dërgohet me shkrim Komitetit të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë, jo më vonë se gjashtë muaj pasi ky Protokoll hyn në fuqi. Të gjitha memorandumet e mirëkuptimit të nënshkruara ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve doganore dhe që i njoftohen Komitetit të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë, paraqiten në matricën bashkangjitur këtij Protokoll si aneksi II, parashikuar në nenin 18.1.

8.5. Një Palë e CEFTA-s nuk kërkon origjinalin ose kopje të deklaratave të eksportit që i janë paraqitur autoriteteve doganore të Palës eksportuese të CEFTA-s si kërkesë për importimin e mallit. Asgjë në këtë paragraf nuk e përjashton një Palë të CEFTA-s që të kërkojë dokumente të tilla si certifikata, leje ose licenca si kërkesë për importimin e mallrave të kontrolluara ose të rregulluara.

8.6. Palët e CEFTA-s nxiten të përdorin standardet përkatëse ndërkombëtare ose pjesë të tyre, si bazë për formalitetet dhe procedurat e importit, eksportit ose transitit të tyre, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë

Protokoll. Palët e CEFTA-s përcaktojnë frekuencën e shqyrtimeve periodike që duhet të ndërmerren, në mënyrë që të informojnë Palët e tjera të CEFTA-s se cilat standarde ndërkombëtare apo pjesë të tyre janë përdorur si bazë për formalitetet dhe procedurat e importit, eksportit dhe transitit. Shqyrtimi i parë bëhet jo më vonë se një vit pasi ky Protokoll hyn në fuqi.

8.7. Palët e CEFTA-s inkurajohen për të koordinuar qëndrimet e tyre dhe për të marrë pjesë, brenda limiteve të burimeve të tyre, në përgatitjen dhe shqyrtimin periodik të standardeve përkatëse ndërkombëtare nga organizatat përkatëse ndërkombëtare.

8.8. Komiteti i Përbashkët e CEFTA-s harton procedurat për shkëmbimin, sipas rastit, të informacioneve përkatëse dhe praktikave më të mira, për zbatimin e standardeve ndërkombëtare nga palët e CEFTA-s.

Neni 9

Procedurat e përbashkëta kufitare dhe kërkesat uniforme të dokumentacionit

9.1. Secila Palë e CEFTA-s zbaton, sipas paragrafit 9.2, procedura të përbashkëta doganore dhe kërkesa uniforme të dokumentacionit për çlirimin dhe zhdoganimin e mallrave në të gjithë territorin e saj. Asgjë në paragrafin 9.2 nuk do të interpretohet se përbën diskriminim arbitrar ose të pajustificueshëm apo kufizim të fshehur ndërmjet Palëve të CEFTA-s kur mbizotërojnë të njëjtat kushte.

9.2. Asgjë në këtë nen nuk e pengon një Palë të CEFTA-s, që të:

a) Diferencojë kërkesat e saj të procedurave dhe dokumentacionit bazuar në natyrën dhe llojin e mallrave ose mjetet e tyre të transportit;

b) Diferencojë kërkesat e saj të procedurave dhe dokumentacionit për mallrat mbi bazën e menaxhimit të riskut;

c) Diferencojë kërkesat e saj të procedurave dhe dokumentacionit për të siguruar përjashtimin e plotë ose të pjesshëm nga detyrimet apo taksat e importit;

d) Zbatojë përpunimin ose depozitimin elektronik; ose

e) Diferencojë kërkesat e saj të procedurave dhe dokumentacionit në përputhje me Marrëveshjen e OBT-së për Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare.

Neni 10

Mallrat e refuzuara

10.1. Kur mallrat e paraqitura për import janë refuzuar nga autoriteti kompetent i Palës së CEFTA-s, për shkak të mospërbushjes së rregullave të përshkruara sanitare ose hidrosanitare apo të rregullave teknike, Pala e CEFTA-s, në bazë të ligjeve dhe rregullave të saj dhe në përputhje me to, lejon importuesin që t'i ridërgojë ose t'i rikthejë eksportuesit mallrat e refuzuara apo një personi tjetër i caktuar nga eksportuesi.

10.2. Kur jepet një opsion i tillë sipas paragrafit 10.1 dhe importuesi nuk e zbaton atë brenda një periudhe të arsyeshme kohore, autoriteti kompetent mund të marrë një kurs tjetër veprimi, në mënyrë që t'i japë zgjidhje problemit të mallrave të tilla që nuk përputhen me rregullat e kërkuara.

Neni 11

Pranimi i përkohshëm i mallrave dhe përpunimi aktiv dhe pasiv

11.1. Pranimi i përkohshëm i mallrave

Secila Palë e CEFTA-s lejon, siç parashikohet në ligjet dhe rregullat e saj, që mallrat të sillen në territorin e saj doganor, me kusht që, tërësisht ose pjesërisht, të lirohen nga pagesa e detyrimeve dhe taksave të importit nëse këto mallra janë sjellë në territorin e saj doganor për një qëllim specifik dhe janë të destinuara për riekспортim brenda një periudhe specifike, dhe nuk kanë pësuar ndryshime përveç zhvlerësimit normal dhe humbjes së shkaktuar nga përdorimi i tyre.

11.2. Përpunimi aktiv dhe pasiv

a) Secila Palë e CEFTA-s lejon, siç parashikohet në ligjet dhe rregullat e saj, përpunimin aktiv dhe pasiv të mallrave. Mallrat që lejohen për përpunim pasiv mund të riimportohen, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet dhe taksat e importit, në përputhje me ligjet dhe rregullat e Palës së CEFTA-s.

b) Për qëllimet e këtij neni, termi “përpunim aktiv” nënkupton procedurën doganore sipas së cilës mallra të caktuara mund të sillen në territorin doganor të Palës së CEFTA-s, me kusht që të lirohen, tërësisht ose pjesërisht, nga detyrimet dhe taksat e importit ose mund të jenë të pranueshme për refinancimin e detyrimeve, bazuar në faktin që mallra të tilla janë të destinuara për prodhim, përpunim ose riparim dhe eksportim të mëvonshëm.

c) Për qëllimet e këtij neni, termi “përpunim pasiv” nënkupton procedurën doganore, sipas së cilës mallrat që janë në qarkullim të lirë në territorin doganor të një Pale të CEFTA-s mund të eksportohen, përkohësisht

për prodhim, përpunim ose riparim jashtë vendit dhe më pas të rimportohen.

Neni 12

Liria e transitit

12.1. Çdo rregull apo formalitet, në lidhje me lëvizjet transit të vendosura nga një Palë e CEFTA-s, nuk do të:

a) Ruhet nëse rrethanat ose objektivat që kanë sjellë miratimin e tyre nuk ekzistojnë më ose nëse rrethanat apo objektivat e ndryshuar mund të trajtohen në një mënyrë më pak treg-kufizuese të arsyeshme në dispozicion;

b) Zbatohen në një mënyrë që do të përbënte një kufizim të fshehur në lëvizjet transit.

12.2. Lëvizjet transit nuk do të kushtëzohen me mbledhjen e tarifave dhe taksave të vendosura në lidhje me transitin, përveç taksave për transportimin e tyre, në përputhje me shpenzimet administrative që rrjedhin nga transiti ose me koston e shërbimeve të kryera.

12.3. Palët e CEFTA-s nuk kërkojnë, marrin apo ruajnë asnjë kufizim vullnetar apo ndonjë masë tjetër të ngjashme për lëvizjet transit. Kjo ndodh pa cenuar rregullat ekzistuese dhe të ardhshme kombëtare, marrëveshjet dypalëshe dhe ndërkombëtare të lidhura me rregullimin e transportit, në përputhje me rregullat e OBT-së.

12.4. Secila Palë e CEFTA-s u akordon produkteve që do të jenë në transit përmes territorit të ndonjë Pale tjetër të CEFTA-s, një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që do t'u ofrohej produkteve të tilla, nëse do të ishin duke u transportuar nga vendi i origjinës në destinacionin e tyre, pa kaluar në territorin e Palës tjetër të CEFTA-s.

12.5. Kërkesat e formaliteteve dhe dokumentacionit, si dhe kontrollet doganore në lidhje me lëvizjet transit nuk do të jenë më të rrepta sesa është e nevojshme, në mënyrë që:

a) Të identifikohen mallrat; dhe

b) Të sigurohet plotësimi i kërkesave të transitit.

12.6. Pasi mallrat i janë nënshtruar procedurës transit dhe janë autorizuar për të vijuar nga pika e origjinës në territorin e një Pale të CEFTA-s, ato nuk do të jenë subjekt i taksave doganore dhe as i vonësve të panevojshme apo kufizimeve deri kur të përfundojnë transitin e tyre në pikën e destinacionit brenda territorit të Palës së CEFTA-s.

12.7. Palët e CEFTA-s nuk zbatojnë rregullat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit në kuadër të kuptimit të Marrëveshjes së OBT-së mbi barrierat teknike të tregtisë së mallrave në transit.

12.8. Palët e CEFTA-s lejojnë dhe sigurojnë paraqitjen dhe përpunimin paraprak të dokumentacionit të transitit dhe të dhënave para mbërritjes së mallrave.

12.9. Pasi lëvizjet transit kanë arritur në zyrën doganore ku bëjnë daljen nga territori i Palës së CEFTA-s, kjo zyrë përfundon menjëherë operacionin e transitit nëse janë plotësuar kërkesat e transitit.

12.10. Kur një Palë e CEFTA-s kërkon garanci në formën e garantit, depozitës apo instrumenti tjetër monetar dhe jomonetar për lëvizjet transit, një garanci e tillë do të kufizohet me sigurimin që janë përmbushur kërkesat që lindin nga një lëvizje e tillë transit.

12.11. Pasi një Palë e CEFTA-s ka vendosur se janë përmbushur kërkesat e transitit, garancia çlirohet pa vonesë.

12.12. Secila Palë e CEFTA-s lejon, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj, garanci të plota, të cilat përfshijnë transaksione të shumta për të njëjtët operatorë ose rinovimin e garancive pa çlirim nga përgjegjësitë për dërgesat e mëvonshme.

12.13. Secila Palë e CEFTA-s vë në dispozicion publikisht informacionet përkatëse që përdor për të përcaktuar garancinë, duke përfshirë transaksionet e vetme dhe, kur është e zbatueshme, garancitë për transaksione të shumta. Të gjitha informacionet, të parashikuara në këtë paragraf, do të vihen në dispozicion në formë elektronike në faqet e internetit të autoriteteve përkatëse kompetente të Palëve të CEFTA-s. Secila Palë e CEFTA-s do të vërë në dispozicion publikimin përkatës në gjuhën e vet kombëtare dhe në gjuhën angleze. I njëjti informacion do të publikohet në *Transparency Pack* të CEFTA-s.

12.14. Secila Palë e CEFTA-s mund të kërkojë përdorimin e grupeve shoqëruese doganore për lëvizjet transit, vetëm në rrethanat që paraqesin rreziqe të larta ose kur përputhshmëria me ligjet dhe rregullat doganore nuk mund të sigurohet përmes përdorimit të garancive. Rregullat e përgjithshme të zbatueshme për grupet shoqëruese doganore publikohen në pajtim me nenin 1 të Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Tregtisë. Të gjitha publikimet të parashikuara në këtë paragraf do të vihen në dispozicion në rrugë elektronike në faqen e internetit të autoriteteve doganore të Palëve të CEFTA-s. Secila Palë e CEFTA-s do të vërë në dispozicion publikimet përkatëse në gjuhën e vet kombëtare dhe në gjuhën angleze.

12.15. Palët e CEFTA-s do të përpiqen të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë veprimet midis tyre, me qëllim që të rrisin lirinë e transitit. Një bashkëpunim dhe koordinim i tillë mund të përfshijë, por pa u kufizuar, kuptimin për:

- a) Taksat;
- b) Formalitetet dhe kërkesat ligjore; dhe
- c) Funkzionimin praktik të regjimeve të transitit.

12.16 Çdo çështje bashkëpunimi dhe koordinimi, përmendur në paragrafin 12.15, do t'i referohet Nënkomitetit të CEFTA-s për Doganat dhe Rregullat e Origjinës, si një çështje me prioritet në rast se nuk është konstatuar më parë asnjë zgjidhje tjetër dypalëshe.

12.17. Secila Palë e CEFTA-s përpiqet që të caktojë një koordinator kombëtar transit, të cilit mund t'i drejtohen të gjitha pyetjet dhe propozimet nga Palët e tjera të CEFTA-s, në lidhje me funksionimin e mirë të operacioneve transit. Palët e CEFTA-s do të vënë në dispozicion të gjitha detajet e komunikimit të koordinatorit të tyre kombëtar transit, përmes Shkëmbimit Sistematik Elektronik të të Dhënave (SEED) ose çdo mjeti tjetër të komunikimit elektronik në dispozicion për të gjitha Palët e CEFTA-s.

Neni 13

Dispozita të veçanta në lidhje me shkëmbimin e të dhënave

13.1. Të dhënat do të shkëmbehen, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, midis autoriteteve doganore dhe autoriteteve kompetente të përfshira në zhdoganimin e mallrave, duke përdorur infrastrukturën për shkëmbimin e të dhënave të vendosur midis doganave, në përputhje me aneksin I të këtij dokumenti, që është pjesë përbërëse e këtij Protokolli. Palët e CEFTA-s nuk do të shkëmbejnë më pak të dhëna se ato të specifikuar në listën minimale të të dhënave, pa cenuar objektin e të dhënave, i cili është rënë dakord të shkëmbehet në rrugë dypalëshe midis Palëve të CEFTA-s.

13.2. Të gjitha listat me të dhënat dypalëshe që do të shkëmbehen në mënyrë elektronike ndërmjet Palëve të CEFTA-s, përveç listës minimale të të dhënave në përputhje me paragrafin 1, do t'i njoftohen Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s nga Palët përkatëse të CEFTA-s, jo më vonë se tre muaj pasi ky Protokoll hyn në fuqi. Në rastin e amendimeve të kryera në listat dypalëshe të njoftuara, për të cilat do të bihet dakord në rrugë dypalëshe nga Palët e CEFTA-s, pas kësaj date, Palët përkatëse të CEFTA-s duhet të njoftojnë amendimet e bëra te kryetari në detyrë i CEFTA-s, i cili do të informojë të gjitha Palët e tjera të CEFTA-s për listat me të dhëna dypalëshe të rëna dakord midis Palëve të CEFTA-s ose amendimet e tyre, menjëherë pas marrjes së një njoftimi të tillë. Asnjë nga nenet e këtij Protokolli nuk zbatohet në shkëmbimin e të dhënave dypalëshe të rëna dakord midis Palëve të CEFTA-s që nuk janë njoftuar.

13.3. Objekti i të dhënave që do të shkëmbehen nëpër kufij mund të jetë i ndryshëm nga objekti i shkëmbyer në nivel kombëtar.

13.4. Secila Palë e CEFTA-s miraton ose përdor procedura që lejojnë dorëzimin e dokumentacionit të importit dhe informacioneve të tjera të kërkuara, duke përfshirë manifestet, për të filluar përpunimin para mbërritjes së mallrave, me qëllim përshpejtimin e çlirimit të mallrave pas mbërritjes.

13.5. Secila Palë e CEFTA-s siguron, për qëllime të depozitimit paraprak, dokumente në format elektronik për përpunimin para mbërritjes të dokumenteve të tilla.

13.6. Secila Palë e CEFTA-s përpunon të dhënat e parambërritjes, të cilat transmetohen elektronikisht në menaxhimin e riskut të të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në zhdoganimin e mallrave, me qëllim përqendrimin e inspektimeve të tyre në dërgesat me risk të lartë, në pajtim me nenin 5.4. Palët e CEFTA-s shqyrtojnë objektin e të dhënave të shkëmbyera në kuadrin e këtij Protokolli, jo më vonë se dy vjet pasi ky Protokoll hyn në fuqi, me qëllim që të vlerësohet nëse objekti ekzistues i shkëmbimit të të dhënave është i mjaftueshëm për efektivitetin e sistemeve të menaxhimit të riskut të Palëve të CEFTA-s, si për lehtësimin e tregtisë dhe për qëllime të sigurisë parandaluese dhe të kontrollit të sigurisë.

13.7. Republika e Moldavisë do të fillojë shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike, siç përcaktohet në aneksin I për listën minimale të të dhënave, vetëm pasi të jetë hedhur në Shkëmbimin Sistematik Elektronik të të Dhënave (SEED).

Neni 14

Siguria e lidhjes

Palët e CEFTA-s, duke përdorur burimet kombëtare të informacionit, përshtatin burimet e tyre kombëtare të informacionit për të shkëmbyer të dhëna, duke përdorur një lidhje të sigurt interneti, duke zbatuar Shkëmbimin Sistematik Elektronik të të Dhënave (SEED)/Rrjetin Virtual Privat (VPN).

Kompleksi i softuerit dhe harduerit për shkëmbimin e informacionit

Për qëllime të rritjes së ndërveprueshmërisë, secila Palë e CEFTA-s, gjatë zbatimit të dispozitave të këtij Protokollit për të krijuar kompleksin e softuerit dhe harduerit, duhet:

- a) Të formojë kompleksin e vet të harduerit, përfshirë softuerin dhe sistemin e komunikimit që ofron shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit;
- b) Të përcaktojë norma që specifikojnë shkallën e ekspozimit dhe procedurat për dokumentimin, aksesin, ruajtjen, si dhe shpërndarjen dhe mbrojtjen e të dhënave;
- c) Të sigurojë konformitetin e kompleksit të softuerit dhe harduerit të shkëmbimit elektronik të të dhënave për sigurinë e informacionit, në përputhje me standardet e Palës në fjalë të CEFTA-s;
- d) Të përcaktojë dhe të zbatojë procedurat e prokurimit për mbajtjen e mëtejshme, pas zbatimit, nëpërmjet mbështetjes kombëtare apo mbështetjeje tjetër buxhetore; dhe
- e) të sigurojë ofrimin e dispozitave të plota, të besueshme dhe në kohë të të dhënave.

Periudha kohore e shkëmbimit elektronik të të dhënave

16.1. Shkëmbimi elektronik i informacionit do të bëhet në kohë reale, në përputhje me strukturën e rënë dakord të transferimit të të dhënave, përbërjen, formatin dhe standardet, në pajtim me aneksin I.

16.2. Struktura e transferimit të të dhënave, formati dhe standardet, do të jenë të njëjta për të gjitha Palët e CEFTA-s.

Ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave

17.1. Të dhënat e ofruara nga Palët e CEFTA-s janë konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime të këtij Protokollit.

17.2. Pa pëlqimin e Palës së CEFTA-s që ofron të dhënat e marra sipas këtij Protokollit, këto të dhëna nuk mund t'i transferohen Palëve të tjera të CEFTA-s.

Transparenca në shkëmbimin e të dhënave në nivel kombëtar

18.1. Palët e CEFTA-s marrin të gjitha masat e nevojshme të kërkuara nga legjislacioni i tyre i brendshëm për të siguruar shkëmbimin e të dhënave midis autoriteteve të tyre doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente të përfshira në zhdoganimin e mallrave. Për qëllime të transparencës, marrëveshjet e arritura në nivel kombëtar, që sigurojnë shkëmbimin e të dhënave ndërinstitucionale, janë paraqitur në një matricë që do t'i bashkëngjitet këtij Protokollit (aneksi II).

18.2. Palët e CEFTA-s përditësojnë listën e memorandumeve të mirëkuptimit/bashkëpunimit në nivel kombëtar, sa herë që bëhen ndryshime në këto memorandume, përmes një matrice që do t'i bashkëngjitet këtij Protokollit. Njoftimet e përditësimeve do t'i drejtohen me shkrim Komitetit të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë.

Pagesat elektronike

19.1. Secila Palë e CEFTA-s miraton dhe përdor procedura që lejojnë mundësinë e pagesave elektronike për detyrimet, taksat, tarifatat dhe pagesat të mbledhura nga autoritetet doganore pas importimit dhe/ose eksportimit.

19.2. Palët e CEFTA-s njoftojnë Komitetin e Përbashkët të CEFTA-s, jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit, me shkrim dhe në gjuhën angleze, për listën e procedurave që mundësojnë pagesat elektronike për detyrimet, taksat, tarifatat dhe pagesat e parashikuara në paragrafin 19.1.

Veçimi i çlirimit të mallrave nga përcaktimi përfundimtar i detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave doganore

20.1. Secila Palë e CEFTA-s miraton ose ruan procedura që lejojnë çlirimin e mallrave para përcaktimit përfundimtar të detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave doganore, nëse një përcaktim i tillë nuk është bërë para ose pas mbërritjes së mallrave ose sa më shpejt pas mbërritjes së mallrave dhe me kusht që të jenë

plotësuar të gjitha kërkesat e tjera të importit/eksportit.

20.2. Si kusht për çlirime të tilla mallrash, Palët e CEFTA-s mund të kërkojnë:

a) Pagesën e detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave doganore të përcaktuara para ose pas mbërritjes së mallrave dhe një garanci për çdo shumë që nuk është përcaktuar ende në formën e një garancie, depozite apo një instrumenti tjetër të përshtatshëm të parashikuar në legjislacionin e tyre; ose

b) Një garanci në formën e një garancie, depozite apo një instrumenti tjetër të përshtatshëm të parashikuar në legjislacionin e tyre.

20.3. Një garanci e tillë nuk duhet të jetë më e madhe se shumta që kërkojnë Palët e CEFTA-s për të siguruar pagesën e detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave doganore që përfundimisht duhen paguar për mallrat e mbuluara nga garancia.

20.4. Në rastin kur është zbuluar një vepër penale që kërkon vendosjen e dënimeve ose gjobave monetare, mund të kërkohet një garanci për dënimet dhe gjobot që mund të vendosen.

20.5. Garancia, e parashikuar në paragrafët 20.2(a) dhe 20.2(b) çlirohet kur nuk kërkohet më.

20.6. Asgjë në këto dispozita nuk ndikon në të drejtën e Palëve të CEFTA-s për shqyrtimin, ndalimin, konfiskimin apo trajtimin e mallrave në një mënyrë të tillë që nuk është në kundërshtim me rregullat sipas Marrëveshjes përkatëse të OBT-së.

Neni 21

Auditimi pas zhdoganimit

21.1. Me qëllim përshpejtimin e çlirimit të mallrave, secila Palë e CEFTA-s miraton ose kryen një auditim pas zhdoganimit për të garantuar përputhshmërinë me të drejtën doganore dhe ligje të tjera të ngjashme.

21.2. Secila Palë e CEFTA-s për zgjedh ndonjë operator ekonomik ose dërgesë për auditim pas zhdoganimit në një mënyrë të bazuar në risk, gjë që mund të përfshijë kriteret e duhura të përzgjedhjes. Secila Palë e CEFTA-s kryen auditime pas zhdoganimit në mënyrë transparente. Kur operatori ekonomik përfshihet në procesin e auditimit dhe janë arritur rezultatet përfundimtare, Pala e CEFTA-s njofton pa vonesë, operatorin ekonomik, të dhënat e të cilit janë duke u audituar për rezultatet, për të drejtat dhe detyrimet e operatorit ekonomik, si dhe arsyet e rezultateve.

21.3. Informacioni i marrë gjatë auditimit të paszhdoganimit mund të përdoret në procedura të mëtejshme administrative ose gjyqësore.

21.4. Palët e CEFTA-s përdorin rezultatin e auditimeve paszhdoganimit në zbatimin e menaxhimit të riskut.

Neni 22

Krijimi i sistemit të matjes dhe publikimi i kohës mesatare të çlirimit të mallrave

22.1. Palët e CEFTA-s synojnë matjen dhe publikimin e kohës së tyre mesatare të çlirimit të mallrave, në mënyrë periodike dhe të qëndrueshme, duke përdorur instrumente të tilla si, ndër të tjera, Studimin e Kohës së Çlirimit të Organizatës Botërore të Doganave (referuar në këtë Protokoll si "OBD"). Secila Palë e CEFTA-s mund të përcaktojë objektin dhe metodologjinë e matjeve të tilla të kohës mesatare të çlirimit të mallrave, në përputhje me nevojat dhe kapacitetin e saj. Secila Palë e CEFTA-s i konfirmon me shkrim Komitetit të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë objektin dhe metodologjinë e matjeve të kohës mesatare të çlirimit menjëherë pasi ky Protokoll hyn në fuqi. Në këtë njoftim, Palët e CEFTA-s mund të vendosin për një periudhë transitorë për zbatimin e këtij neni, e cila nuk duhet të jetë më shumë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli.

22.2. Palët e CEFTA-s janë angazhuar të ndajnë me Komitetin e CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë përvojat e tyre në matjen e kohës mesatare të çlirimit, duke përfshirë metodologjitë e përdorura, vështirësitë e identifikuara dhe të gjitha efektet që rezultojnë për efikasitetin.

Neni 23

Mallrat që prishen shpejt¹

23.1. Me qëllim parandalimin e humbjes së pashmangshme apo dëmtimin e mëtejshëm të mallrave që prishen shpejt dhe, me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kërkesat rregullatore, secila Palë e CEFTA-s duhet të çlirojë mallrat që prishen:

a) Në rrethana normale brenda një kohe sa më të shkurtër; dhe

¹ Për qëllime të kësaj dispozite, mallrat që prishen shpejt janë mallrat që kalben me shpejtësi për shkak të karakteristikave të tyre natyrore, veçanërisht në mungesë të kushteve të përshtatshme të magazinimit.

b) Në rrethana të jashtëzakonshme, sipas rastit, jashtë orarit të punës së autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente.

23.2. Secila Palë e CEFTA-s duhet t'u japë përparësi mallrave që prishen shpejt kur planifikon ekzaminimet që mund të kërkohen.

23.3. Secila Palë e CEFTA-s duhet të planifikojë ose të lejojë një operator ekonomik të rregullojë magazinimin e duhur të mallrave që prishen shpejt të cilat janë në pritje që të çlirohen. Palët e CEFTA-s mund të kërkojnë që çdo objekt magazinimi i rregulluar nga operatori ekonomik të jetë miratuar ose të jetë përcaktuar nga autoritetet përkatëse. Lëvizja e mallrave në këto objekte magazinimi, duke përfshirë autorizimet për lëvizjen e mallrave nga operatori, mund të jetë subjekt miratimi, kur kërkohet, nga autoritetet kompetente. Palët e CEFTA-s duhet të sigurojnë, kur është e mundur dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm, me kërkesën e operatorit ekonomik, zhvillimin e procedurave të nevojshme për çlirimin e mallrave në ato objekte magazinimi.

23.4. Në rastet e vonesave të konsiderueshme në çlirimin e mallrave që prishen shpejt dhe përmes një kërkesë më shkrim, Pala importuese e CEFTA-s, duhet të komunikojë, në masën e mundshme, arsyet e vonesës.

Neni 24

Bashkëpunimi kufitar dhe me agjenci të tjera

24.1. Secila Palë e CEFTA-s duhet të sigurojë se autoritetet e saj kompetente, përgjegjëse për kontrollet kufitare dhe procedura të tjera që merren me importimin, eksportimin dhe transitin e mallrave, bashkëpunojnë midis tyre dhe koordinojnë aktivitetet e tyre me qëllim lehtësimin e tregtisë.

24.2. Palët e CEFTA-s kujdesen që, përmes një grupi përfaqësues të posaçëm nga autoritetet kompetente dhe në emër të tyre, një nga shërbimet e tjera të përfaqësuara dhe, mundësisht, shërbimet doganore, mund të kryhen inspektime për të cilat ato autoritete janë përgjegjëse dhe, për aq kohë sa inspektime të tilla lidhen me kërkesën për të prodhuar dokumentet e nevojshme, mund të kryhen edhe kontrole mbi vlefshmërinë dhe vërtetësinë e tyre dhe mbi identitetin e mallrave të deklaruar në dokumente të tilla. Në këtë rast, autoritetet përkatëse duhet të sigurojnë se janë vënë në dispozicion mjetet e nevojshme për kryerjen e kontrolleve të tilla.

24.3. Palët e CEFTA-s, duhet të njohin, në rastin e mallrave që importohen ose hyjnë transit, ligjet dhe procedurat që lidhen me inspektimet e kryera dhe dokumentet e hartuara nga autoritetet kompetente të Palës tjetër të CEFTA-s, të cilat vërtetojnë se mallrat janë në përputhje me kërkesat ligjore të vendit të importit ose me kërkesat ekuivalente të vendit të eksportit, me kusht që këto ligje dhe procedura, si dhe zbatimi i tyre, të jenë plotësisht në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së. Miratimi i statusit të harmonizimit me BE-në ndërmerret në përputhje me procedurat përkatëse për miratimin e përafrimit me BE. Procedurat e miratimit miratohen nga Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s. Asnjë njohje e inspektimeve dhe dokumenteve nuk është e mundur para këtij miratimi, siç parashikohet në këtë paragraf, pa cenuar asnjë instrument ligjor dypalësh midis Palëve të CEFTA-s.

24.4. Kur volumi i lëvizjeve kërkon një gjë të tillë, Palët e CEFTA-s kujdesen që:

a) Postat kufitare janë të hapura, përveç rasteve kur lëvizja është e ndaluar, në mënyrë që:

- Kufijtë të mund të kalohen 24 orë në ditë me kryerjen e inspektimeve dhe formaliteteve përkatëse për mallrat e vendosura nën regjimin e transitit doganor, për mjetet e tyre të transportit dhe automjetet që udhëtojnë pa ngarkesë, përveç rasteve kur inspektimi kufitar është i nevojshëm për të parandaluar përhapjen e sëmundjes ose për të mbrojtur kafshët;

- Inspektimet dhe formalitetet që lidhen me lëvizjen e mallrave dhe mjeteve të transportit, të cilat nuk lëvizin nën regjimin e transitit doganor, të mund të kryhen nga e hëna deri të premten gjatë një periudhe të pandërprerë prej së paku 10 orësh dhe të shtunën gjatë një periudhe të pandërprerë prej së paku 6 orësh, nëse këto ditë nuk janë festa publike;

b) Në lidhje me automjetet dhe mallrat e transportuara nga ajri, periudhat e referuara në paragrafin e dytë të pikës "a" do të përshtaten në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat aktuale dhe, për këtë qëllim, do të ndahen ose zgjerohen nëse është e nevojshme.

24.5. Kur disa posta kufitare ndodhen në afërsi të një zone të caktuar kufitare, Palët e CEFTA-s mund të bien dakord së bashku, për disa nga këto posta, që t'i përjashtojnë nga parashikimet në paragrafin 24.1, me kusht që postat e tjera në këtë zonë të jenë në gjendje të bëjnë zhdoganimin e mallrave dhe mjeteve në përputhje me këtë paragraf.

24.6. Për sa u përket postave kufitare dhe zyrave doganore dhe shërbimeve të referuara në paragrafin 24.1 dhe, sipas kushteve të përcaktuara nga Palët e CEFTA-s, autoritetet kompetente duhet, nëse kërkohet në

mënyrë specifike gjatë orëve të punës dhe për arsye bindëse, të parashikojnë inspektimet dhe formalitetet që do të kryhen, si përjashtim, jashtë orëve të punës, me kusht që, sipas rastit, të bëhet pagesa për shërbimet e kryera në këtë mënyrë.

24.7. Palët e CEFTA-s përpiqen të knjojnë në postat kufitare, kur teknikisht është e mundur dhe e justifikuar me volumin e lëvizjeve, korsi të posaçme të rezervuara për mallrat e vendosura nën regjimin e transitit doganor, mjetet e tyre të transportit, automjetet që udhëtojnë pa ngarkesë dhe të gjitha mallrat subjekt i inspektimeve dhe i formaliteteve të tilla, meqenëse nuk tejkalojnë ato që kërkohen në lidhje me mallrat e vendosura nën regjimin e transitit.

24.8. Zbatimi i neneve 24.4, 24.5, 24.6 dhe 24.7 fillon dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit pa cenuar asnjë nga aktet ligjore dypalëshe midis Palëve të CEFTA-s që të bien dakord para kësaj date. Të gjitha aktet ligjore dypalëshe përkatëse, të lidhura para kësaj date, do t'i njoftohen menjëherë, me shkrim dhe në gjuhën angleze, Komitetit të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë, pas hyrjes në fuqi të akteve përkatëse ligjore dypalëshe.

Neni 25

Operatori ekonomik i autorizuar (OEA)

25.1. Statusi i "Operatorit ekonomik të autorizuar" (OEA) jepet nga secila Palë e CEFTA-s në përputhje me aneksin III të këtij Protokollit. Pezullimi, refuzimi, revokimi dhe anulimi i statusit të operatorit ekonomik të autorizuar do të bëhet, gjithashtu, në përputhje me aneksin III. Statusi i OEA-së do të njihet nga Palët e tjera të CEFTA-s, me kusht që zbatimi i programeve të OEA-së, të jetë në përputhje të plotë me aneksin III. Statusi i përafrimit dhe i implementimit të çdo programi të OEA-së do të miratohet nga Palët e tjera të CEFTA-s, pa cenuar inspektimet doganore, në përputhje me procedurat përkatëse, të cilat do të miratohen nga Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s.

25.2. Në secilën Palë të CEFTA-s, OEA-të do të gëzojnë lehtësime në lidhje me të gjitha kontrollet doganore të specifikuara në aneksin III.

Neni 26

Shkëmbimi i informacionit midis Palëve të CEFTA-s për programet e tyre të OEA-ve

Palët e CEFTA-s informojnë rregullisht njëra-tjetrën mbi identitetin e OEA-ve të tyre, për qëllime të sigurisë dhe përfshijnë informacionin në vijim:

- a) Identifikimi i tregtarit;
- b) Emri dhe adresa e OEA-së;
- c) Numri i dokumentit që jep statusin e OEA-së;
- d) Statusi aktual (aktiv, i pezulluar, i revokuar);
- e) Periudhat e ndryshimeve të statusit;
- f) Data në të cilën certifikata hyn në fuqi; dhe
- g) Autoriteti që ka lëshuar certifikatën.

Neni 27

Mbrojtja e sekretit profesional dhe të dhënave personale

27.1. Të dhënat e shkëmbyera nga Palët e CEFTA-s gëzojnë mbrojtjen e sekretit profesional dhe të dhënave personale, të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi në territorin e Palës marrëse të CEFTA-s.

27.2. Në veçanti, këto të dhëna nuk do t'u kalojnë personave që nuk janë pjesë e autoriteteve kompetente të Palës së CEFTA-s në fjalë dhe as nuk do të përdoren nga këto autoritete për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Protokoll.

Neni 28

Njoftimi i inspektimeve dhe formaliteteve të reja

28.1. Kur një Palë e CEFTA-s synon të përfshijë një inspektim ose formalitet të ri në një zonë të ndryshme nga ato që mbulohen nga ky Protokoll, kjo Palë duhet të informojë Palët e tjera të CEFTA-s, të paktën gjashtëdhjetë ditë përpara prezantimit të inspektimit ose formalitetit të ri.

28.3. Pala e CEFTA-s në fjalë duhet të sigurojë se masat e marra për të lehtësuar kalimin e kufijve nuk janë bërë të paefektshme nëpërmjet zbatimit të këtyre inspektimeve ose formaliteteve të reja.

Ndalimet ose kufizimet mbi importin, eksportin ose transitin e mallrave

29.1. Dispozitat e këtij Protokoll nuk përjashtojnë ndalimet ose kufizimet mbi importin, eksportin ose transitin e mallrave të miratuara nga Palët e CEFTA-s dhe të arsyetuara në bazë të moralit publik, politikave publike ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve, bimëve ose mjedisit, mbrojtjes së pasurive kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike apo mbrojtjes së pronësisë industriale ose tregtare.

29.2. Secila Palë e CEFTA-s duhet të zbatojë këtë nen, në mënyrë që të shmangët diskriminimi arbitrar ose i pajustificueshëm midis Palëve të CEFTA-s kur mbizotërojnë të njëjtat kushte ose një kufizim i fshehur mbi tregtinë ndërmjet Palëve të CEFTA-s.

Organi zbatues

Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s mbikëqyr dhe administron zbatimin e këtij Protokoll në pajtim me nenet 40 dhe 41 të CEFTA 2006.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në pajtim me nenin 14.4 të CEFTA 2006, Palët e CEFTA-s zbatojnë të gjitha dispozitat e këtij Protokoll për thjeshtësimin dhe lehtësimin e procedurave doganore dhe reduktimin e formaliteteve të vendosura mbi tregtinë. Çdo mosmarrëveshje midis Palëve të CEFTA-s në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokoll, do të jetë subjekt i procedurës së parashikuar në nenin 42 të CEFTA 2006.

Zbatimi i Protokollit

Secila Palë e CEFTA-s do të marrë masat e duhura për të garantuar se dispozitat e këtij Protokoll janë zbatuar në mënyrë efektive dhe harmonike, duke marrë parasysh nevojën për të lehtësuar kalimin e mallrave në kufi dhe nevojën për të arritur zgjidhje të kënaqshme reciproke për të gjitha vështirësitë që lindin nga zbatimi i dispozitave të mësipërme.

Rishikimi i Protokollit

Ky Protokoll dhe anekset e tij janë pjesë përbërëse e CEFTA 2006. Çdo amendim i këtij Protokoll do të bëhet në pajtim me nenin 47 të CEFTA 2006.

Mospërputhja

Në rast mospërputhjeje të rëndësishme të të dhënave në shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit, palët e CEFTA-s do të zhvillojnë konsultime dypalëshe për të identifikuar arsyet, brenda një muaji nga njoftimi i mospërputhjes dhe për të eliminuar gabimet sa më shpejt.

Ratifikimi i Protokollit

35.1. Ky Protokoll është subjekt i ratifikimit, i pranimit apo i miratimit, në përputhje me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i secilës Palë të CEFTA-s. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit ose të miratimit do të depozitohen te depozituesi.

35.2. Ky Protokoll hyn në fuqi tridhjetë ditë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit.

35.3. Për secilën Palë të CEFTA-s që depoziton instrumentin e ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, ky Protokoll Shtesë 5 hyn në fuqi tridhjetë ditë pas datës në të cilën Pala e mësipërme e CEFTA-s depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit.

35.4. Nëse kërkesat kushtetuese e lejojnë, çdo Palë e CEFTA-s mund të zbatojë përkohësisht këtë Protokoll. Zbatimi i përkohshëm i këtij Protokoll, në përputhje me këtë paragraf, i njoftohet depozituesit.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e të gjitha Palëve të CEFTA-s, duke qenë rregullisht të autorizuar,

kanë nënshkruar këtë Protokol Shtesë.

Bërë në (përfshini vendin), më, në një kopje të vetme autentike në gjuhën angleze, e cila depozitohet te depozitari i CEFTA-s 2006 dhe e cila u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha Palëve të CEFTA-s.

ANEKSI I SHKËMBIMI ELEKTRONIK I TË DHËNAVE

1. Thjeshtësimi i inspektimeve që lidhen me procedurat e zhdoganimit dhe ulja e formaliteteve sa më shumë që të jetë e mundur

1.1. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet organeve kompetente të përfshira në zhdoganimin e mallrave

Kjo pjesë përcakton:

- Institucionet që do të shkëmbejnë të dhëna;
- Llojet e dokumenteve që do të shkëmbehen ndërmjet Palëve të CEFTA-s;
- Standardet ndërkombëtare/modelet përkatëse të përdorura;

Në këtë shtojcë I të këtij aneksi paraqiten përshkrime të hollësishme të qëllimit, përfutimet që priten të marrin institucionet qeveritare/komuniteti i biznesit, subjektet, grupi i të dhënave, nxitja, ndërlidhja, integrimi dhe komunikimi i shtresave të të dhënave ndërmjet autoriteteve kompetente të përfshira në zhdoganimin e mallrave.

Tabela 1.1. (1). Dokumentet për t'u shkëmbyer

	Lloji i dokumentit	Pala CEFTA lëshuese	Pala CEFTA marrëse	Standardi*/Modeli në përdorim
1.	Certifikatë Shëndetësore Veterinare për produktet me origjinë shtazore	Pala e eksportit - Autoriteti veterinar/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit/Ministria e Bujqësisë	Pala e importit – Autoriteti veterinar/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit/Ministria e Bujqësisë	Bashkimi Evropian - Certifikata Veterinare në BE
2.	Certifikatë Shëndetësore Veterinare për kafshët e gjalla	Pala e eksportit - Autoriteti veterinar/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit/Ministria e Bujqësisë	Pala e Importit - Autoriteti veterinar/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit/Ministria e Bujqësisë	Bashkimi Evropian - Certifikata Veterinare në BE
3.	Certifikatë Fitosanitare për Eksport	Pala e eksportit - Fitosanitare/ bujqësore/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit/ Ministria e Bujqësisë	Pala e importit - Fitosanitare/ bujqësore/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit/ Ministria e Bujqësisë	Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve - SNMF 12 (Standardet ndërkombëtare për masat fitosanitare - 12) - aneksi 1, Model i Certifikatës Fitosanitare për Eksportin
4.	Certifikatë Fitosanitare për Rieksport	Pala e eksportit - Fitosanitare/ Autoriteti Bujqësor/Ministria e Bujqësisë	Pala e eksportit - Fitosanitare/ Autoriteti bujqësor/ Ministria e Bujqësisë	Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve - ISPM 12 (Standardet ndërkombëtare për masat fitosanitare - 12) - aneksi 2, Model i Certifikatës Fitosanitare për Rieksportin
5.	Certifikatë e një produkti farmaceutik	Pala e eksportit - Agjencia e Barnave/Ministria e Shëndetësisë	Pala e importit - Agjencia e Barnave/ Ministria e Shëndetësisë	Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) - Model i Certifikatës së një Produkti Farmaceutik
6.	Leje eksporti për grupet e medikamenteve që përmbajnë substanca të kontrolluara	Pala e eksportit - Agjencia e Barnave/ Ministria e Shëndetësisë	Pala e importit - Agjencia e Barnave/ Ministria e Shëndetësisë	Nuk ka standard/model specifik në përdorim

* Protokolli Shtesë 5, neni 8.6. Palët e CEFTA-s nxiten të përdorin standardet ndërkombëtare përkatëse ose pjesë të tyre si bazë për formalitetet dhe procedurat e tyre të importit, eksportit apo transitit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Protokol.

1.2. Përshkrimet e hollësishme të shtresave të subjekteve dhe kategorive të të dhënave

Kjo pjesë përcakton të grupet e zakonshme të të dhënave të paraqitura në Tabelën 1.1. (1) që do të do të shkëmbehen ndërmjet Palëve të CEFTA-s:

- Kolona e parë përcakton referencat e kutizës së caktuar për dokumentin në fjalë (nëse ka);
- Kolona e dytë paraqet emrin e të dhënave të depozituara për t'u shkëmbyer;
- Kolona e tretë përcakton nëse të dhënat e depozituara janë:
- D - Të detyrueshme;
- F - Opsionale;
- K - Të kushtëzuara;

Tabela 1.2.(1). Certifikata Shëndetësore Veterinare për Produktet me Origjinë Shtazore

1.	Certifikata Shëndetësore Veterinare për Produktet me Origjinë Shtazore	D/F/K
I	Pjesa I - Informacion në lidhje me dërguesin/marrësin	
I.1.	Dërguesi	
	Emri	D
	Adresa	D
	Tel.	D
I.2.	Numri referencës së certifikatës	D
I.3.	Autoriteti kompetent qendror	D
I.4.	Autoriteti kompetent vendor	D
I.5.	Marrësi	
	Emri	D
	Adresa	D
	Kodi postar	F
	Tel.	F
I.6.	Personi përgjegjës për dorëzimin në destinacion	
	Emri	D
	Adresa	D
	Kodi postar	F
	Tel.	F
I.7.	Shteti i origjinës (shteti i origjinës/Kodi ISO)	D
I.8.	Rajoni i origjinës (rajoni i origjinës/Kodi)	D
I.9.	Shteti i destinacionit (shteti i destinacionit/Kodi ISO)	D
I.10.	Rajoni i destinacionit (rajoni i destinacionit/Kodi)	F
I.11.	Vendi i origjinës	
	Emri:	D
	Miratimi nr.:	D
	Adresa:	D
I.12.	Vendi i destinacionit	
	Vendi i destinacionit	D
	Adresa	D
I.13.	Vendi ku është kryer ngarkesa	
	Vendi ku është kryer ngarkesa	D
	Adresa	D
	Miratimi nr.	D
I.14.	Data e nisjes	D
I.15.	Mjetet e transportit (shënjo kutitë e dubura)	
	Aeroplan - vagon hekurudhor – automjet rrugor - tjetër/identifikimi/referenca e dokumentit	D
I.16.	Pika e inspektimit kufitar në hyrje në Palën CEFTA importuese	D
I.17.	Nr. (at) e CITES (Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër)	F
I.18.	Përshkrim i artikullit	D
I.19.	Kodi artikullit (kodi HS)	D
I.20.	Sasia	D
I.21.	Temperatura e produktit (shënjo kutitë e dubura)	
	Ambienti - e ftohtë - e ngrirë	D
I.22.	Numri i paketimeve	D
I.23.	Identifikimi i kontejnerit/numri i vulës	D
I.24.	Lloji i paketimit	D
I.25.	Artikujt e certifikuar për (shënjo kutitë e dubura)	
	Për konsum njerëzor - ushqim për kafshët - përdorim teknik	D
I.26.	Për transit drejt shteteve të treta (shteti/kodi ISO)	F
I.27.	Për import ose pranin në Palën CEFTA importuese	D
I.28.	Identifikimi i artikujve	
	Lloji [emri shkencor]	D
	Numri i miratuar i objektit	D
	Natyra e artikullit	D
	Lloji i trajtimit	D
	Thertore	D
	Numri i paketimeve	D
	Miratimi nr.	D

1.	Certifikata Shëndetësore Veterinare për Produktet me Origjinë Shtazore	D/F/K
	Pesha neto	D
	Vendi i therjes	F
	Numri i paketimit	D
	Ruajtje në të ftohtë	D
	Inspektori zyrtar	
	Emri	D
	Kualifikimi dhe pozicioni	D
	Data	D
	Autoriteti kompetent	D
II²	Pjesa II – Certifikata (informacion shëndetësor)	D
II.1.	Vërtetim shëndetësor	D
II.2.	Vërtetim shëndetësor publik	D
II.2.	Vërtetim shëndetësor i kafshës	D
	Shënime	F

Tabela 1.2.(2). Certifikata Shëndetësore Veterinare për Kafshët e Gjalla

2.	Certifikata Shëndetësore Veterinare për Kafshët e Gjalla	D/F/K
I	Pjesa I- Informacion në lidhje me dërguesin/marrësin	
I.1.	Dërguesi	
	Emri	D
	Adresa	D
	Tel	D
I.2.	Numri referencës së certifikatës	D
I.3.	Autoriteti kompetent qendror	D
I.4.	Autoriteti kompetent vendor	D
I.5.	Marrësi	
	Emri	D
	Adresa	D
	Kodi postar	F
	Tel.	F
I.6.	Personi përgjegjës për dorëzimin në destinacion	
	Emri	D
	Adresa	D
	Kodi postar	F
	Tel.	F
I.7	Shteti i origjinës (shteti i origjinës/Kodi ISO)	D
I.8.	Rajoni i origjinës (rajoni i origjinës/Kodi)	F
I.9.	Shteti i destinacionit (shteti i destinacionit/Kodi ISO)	D
I.10.	Rajoni i destinacionit (rajoni i destinacionit/Kodi)	D
I.11.	Vendi i origjinës	
	Emri	D
	Miratimi nr.	D
	Adresa	D
I.12.	Vendi i destinacionit	
	Vendi i destinacionit	D
	Adresa	D
I.13.	Vendi ku është kryer ngarkesa	
	Vendi ku është kryer ngarkesa	D
	Adresa	D
	Miratimi nr.	D
I.14.	Data e nisjes	D
I.15.	Mjetet e transportit (shënjo kutitë e dubura)	
	Aeroplan - vagon hekurudhor - automjet rrugor - tjetër/identifikimi/referenca e dokumentit	D
I.16.	Pika e inspektimit kufitar në hyrje në Palën CEFTA importuese	D
I.17.	Nr. (at) e CITES (Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër)	F
I.18.	Përshkrim i artikullit	D
I.19.	Kodi i artikullit (Kodi HS)	D
I.20.	Sasia	D
I.22.	Numri i paketimeve	D
I.23.	Identifikimi i kontejnerit/Numri i vulës	D
I.24.	Lloji i paketimit	D
I.25.	Artikujt e certifikuar për (shënjo kutitë e dubura)	
	Therje - mbarështim - mbajta me zinxhir	D
I.26.	Për transit drejt shteteve të treta (shteti/Kodi ISO)	F

² Teksti i plotë i pjesës së certifikatës që do të shkëmbehet ndërmjet Palëve është miratuar dhe përcaktuar ndërmjet palëve në mënyrë të dyanshme (ndërmjet secilës palë të CEFTA-s) dhe sidomos për çdo lloj malli që kërkon certifikatë shëndetësore veterinare. Ndryshimet e tekstit në pjesën e certifikimit do të miratohen në mënyrë të dyanshme ndërmjet palëve të CEFTA-s në fjalë.

2.	Certifikata Shëndetësore Veterinare për Kafshët e Gjalla	D/F/K
I.27.	Për import ose pranin në Palën CEFTA të importit	D
I.28.	Identifikimi i artikujve	
	Lloji [emri shkencor]	D
	Gjinia	D
	Sistemi i identifikimit	D
	Numri i identifikimit	D
	Mosha	D
	Gjinia	D
	Inspektori zyrtar	
	Emri	D
	Kualifikimi dhe pozicioni	D
	Data	D
	Autoriteti kompetent	D
II ³	Pjesa II - Certifikata (informacion shëndetësor)	
II.1.	Vërtetim shëndetësor	D
II.2.	Vërtetim shëndetësor publik	D
II.2.	Vërtetim shëndetësor i kafshës	D
II.3.	Dëshmia e transportit të kafshës	D
	Shënime	

Tabela 1.2.(3). Certifikata Fitosanitare për Eksport

3.	Certifikata Fitosanitare për Eksport	D / F
	Të dhënat e certifikatës	
1.	Emri dhe adresa e eksportuesit	D
2.	Numri i certifikatës	D
	Përshkrim i ngarkesës	
3.	Emri dhe adresa e deklaruar e marrësit	D
4.	Organizata për mbrojtjen e bimëve (autoriteti lëshues)	D
5.	Vendi i origjinës	D
6.	Mjetet e deklaruar të transportimit	D
5.	Vendi i origjinës	D
6.	Mjetet e deklaruar të transportimit	D
7.	Pika e deklaruar e hyrjes	D
8.	Shenja dalluese	
a.	Numri dhe përshkrimi i paketimit	D
b.	Emri i produktit	D
c.	Emri botanik i bimëve	D
9.	Sasia e deklaruar	D
10	Lloji i certifikatës: Eksport	
	Kjo vërteton se bimët, produktet bimore ose artikuj të tjerë të rregulluar të përshkruar këtu janë inspektuar dhe/ose testuar në përputhje me procedurat e përkatëse zyrtare dhe konsiderohen si të lira nga parazitët e karantinës të përcaktuara nga pala kontraktuese importuese dhe në përputhje me kërkesat fitosanitare aktuale të palës kontraktuese importuese, përfshirë kërkesat e parazitëve që nuk kërkojnë vendosjen e karantinës.	D
	Deklaratë shtesë	
11.	Deklaratë shtesë	F
	Dezinfektim dhe/ose trajtim dezinfektues	
12.	Trajtim	D
13.	Kimiketet (përbërësi aktiv)	F
14.	Kohëzgjatja dhe temperatura	F
15.	Përqendrimi	F
16.	Data	D
17.	Të dhëna shtesë	
a)	Vendi i lëshimit	D
b)	Emri dhe firma e nëpunësit të autorizuar	D
c)	Data	D

Tabela 1.2.(4). Certifikata Fitosanitare për Riekspor

4.	Certifikata Fitosanitare për Riekspor	D / F / K
	Të dhënat e certifikatës	
1.	Emri dhe adresa e eksportuesit	D
2.	Numri i certifikatës	D
	Përshkrim i ngarkesës	
3.	Emri dhe adresa e deklaruar e marrësit	D
4.	Organizata për mbrojtjen e bimëve (autoriteti lëshues)	D
5.	Vendi i origjinës	D

³ Teksti i plotë i pjesës së certifikatës që do të shkëmbehet ndërmjet Palëve është miratuar dhe përcaktuar ndërmjet palëve në mënyrë të dyanshme (ndërmjet secilës palë të CEFTA-s) dhe sidomos për çdo lloj malli që kërkon certifikatë shëndetësore veterinare. Ndryshimet e tekstit në pjesën e certifikimit do të miratohen në mënyrë të dyanshme ndërmjet palëve të CEFTA-s në fjalë.

4.	Certifikata Fitosanitare për Rieksport	D / F / K
6.	Mjetet e deklaruar të transportimit	D
5.	Vendi i origjinës	D
6.	Mjetet e deklaruar të transportimit	D
7.	Pika e deklaruar e hyrjes	D
8.	Shenja dalluese	
a)	Numri dhe përshkrimi i paketimit	D
b)	Emri i produktit	D
c)	Emri botanik i bimëve	D
9)	Sasia e deklaruar	D
10.	Lloji i certifikatës: Eksport	
	Kjo vërteton se bimët, produktet bimore dhe të artikuj të tjerë të rregulluar të përshkruar këtu janë importuar.	
	[Pala CEFTA e rieksporitit]	D
	Nga	
	[Shteti i origjinës]	D
	Mbuluar nga certifikata fitosanitare	
	[Numri i certifikatës]	D
	[Origjinal]	F
	[Kopje e njëzuar me origjinalin]	F
	Së cilës i bashkëngjitet kjo certifikatë; dhe që ato janë	
	[Paketuar]	F
	[Ripaketuar]	F
	Në	
	[Origjinal]	F
	[E re]	F
	Që mbështetet në	
	[Certifikata fitosanitare origjinale] dhe [Inspektim shtesë],	F F
	Konsiderohen të jenë në përputhje me kërkesat aktuale fitosanitare të palës kontraktuese importuese dhe gjatë ruajtjes në	
	[Pala CEFTA rieksportuese]	D
	Dërgesa nuk ka qenë e rrezikuar nga prekje apo infektimi	
	Deklaratë shtesë	
11.	Deklaratë shtesë	F
	Dezinfektim dhe/ose trajtim dezinfektues	
12.	Trajtim	D
13.	Kimikatat (përbërësi aktiv)	F
14.	Kohëzgjatja dhe temperatura	F
15.	Përqendrimi	F
16.	Data	D
17.	Të dhëna shtesë	F
a)	Vendi i lëshimit	D
b)	Emri dhe firma e nëpunësit të autorizuar	D
c)	Data	D

Tabela 1.2.(5). Certifikata e një produkti farmaceutik

5.	Certifikata e një produkti farmaceutik	D / F / K
	Agjencia përgjegjëse	D
	Numri	D
	Data e lëshimit	D
	Vendi i lëshimit	D
	Nr. i certifikatës	D
	Dërguesi /eksportues [autoriteti barnave nga një Palë CEFTA eksportuese]	D
	Marrësi/importues [autoriteti barnave nga një Palë CEFTA importuese]	D
1.	Emri dhe forma e dozimit e produktit:	D
1.1.	Përbërësi(it) aktiv dhe sasia(të) për dozë	D
1.2.	Është ky produkt i licencuar për t'u hedhur në treg për përdorim në shtetin eksportues?	(PO/JO)
1.3.	A është ky produkt aktualisht në treg në shtetin eksportues?	(PO/JO)
	<i>Nëse përgjigja ndaj pikës 1.2. është PO (vazhdoni me seksionin 2A dhe bëni seksionin 2B)</i>	
2.A.1.	Numri i licencës së produktit dhe data e lëshimit	K, D
2.A.2.	Mbajtësi i licencës së produktit (emri dhe adresa)	K, D
2.A.3.	Statusi i mbajtësit të licencës së produktit	K, D
2.A.3.1.	Për kategoritë "b" dhe "c", emri dhe adresa e prodhuesit që ka prodhuar formën e dozimit	K, F
2.A.4.	A është bashkëngjitur një përmbledhje për miratim?	(PO/JO)
2.A.5.	Është dokumenti bashkëngjitur informacion mbi produktin, i miratuar zyrtarisht, i plotë dhe në përputhje me licencën?	(PO/JO/NUK JEPET)
2.A.6.	Aplikant për certifikatë, nëse është e ndryshme nga mbajtësi i licencës (emri dhe adresa)	K
	<i>Nëse përgjigja ndaj pikës 1.2 është JO (bëni seksionin 2A dhe jepni të dhëna nga seksioni 2B)</i>	
2.B.1.	Aplikant për certifikatë (emri dhe adresa)	K, D
2.B.2.	Statusi i aplikantit:	K, D
2.B.2.1.	Për kategoritë "b" dhe "c", emri dhe adresa e prodhuesit që ka prodhuar formën e dozimit	K, F

2.B.3.	Përse mungon autorizimi i marketingut? (nuk duhet/nuk u kërkua/në shqyrtim/refuzuar)	K, D
2.B.4.	Shënime	K, F
3.	A e cakton autoriteti certifikues inspektimin periodik në fabrikën e prodhimit ku është prodhuar forma e dozimit?	(PO/JO/NUK APLIKOHET)
	<i>(Nëse jo ose jo e zbatueshme, kalo te pyetja 4)</i>	
3.1.	Shpeshtësia e inspektimeve rutinë (vite)	K, D
3.2.	A është inspektuar prodhuesi i këtij lloji dozimi?	(PO/JO)
3.3.	A janë fabrikat dhe operacionet në përputhje me praktikat për prodhimin e mallrave të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë?	(PO/JO/NUK APLIKOHET)
4.	Informacioni i paraqitur nga aplikanti "a" është i pranueshëm për autoritetin e certifikimit në të gjitha aspektet e prodhimit të produktit	(PO/JO)
	<i>(Nëse jo, jep shpjegime)</i>	
	Shpjegime	K, D
	Adresa e autoritetit certifikues:	D
	Telefon/faksimile:	F
	Emri i personit të autorizuar:	D
	Data:	D

Tabela 1.2.(6). Autorizimi i eksportit për grupe barnash që përmbajnë substanca të kontrolluara

6.	Autorizimi i eksportit për grupe barnash që përmbajnë substanca të kontrolluara	D / F / K
	Numri i autorizimit	D
	INN - emri ndërkombëtar jo i mbrojtur nga pronësia intelektuale	D
	Tarifa doganore	D
	Emri i prodhuesit, fora, fuqia, paketimi	D
	Njësia e matjes	D
	Sasia e mallrave për eksport	D
	Sasia e substancave të miratuara për eksport	D
	Eksportuesi	
	Emri	D
	Adresa	D
	Kodi postar	F
	Qyteti	F
	Shteti	F
	Importuesi	
	Emri	D
	Adresa	D
	Kodi postar	D
	Qyteti	D
	Pala CEFTA	D
	Numri i autorizimit të importit i lëshuar nga shteti i importit	D
	Data e autorizimit të importit e lëshuar nga shteti i importit	D
	Përdoruesi fundor	
	Emri	D
	Adresa	D
	Kodi postar	D
	Qyteti	D
	Pala CEFTA	D
	Qëllimi i eksportit	D
	Mënyra e transportit e substancës/substancave të miratuara	D
	Emri i pikës kufitare të kalimit	D
	Emri i zyrës doganore	D
	Emri i transportuesit të dërgesës	D
	Autorizim i lëshuar më	D
	Autorizim i vlefshëm deri më	D
	Shënime të posaçme	
	1. Autorizimi aplikohet vetëm për një import	D
	2. Nëse importi/eksporti nuk kryhet brenda periudhës së caktuar në autorizimin e import/eksportit, importuesi/eksportuesi është i detyruar të informojë agjencinë për këtë gjë dhe të kthejë të gjitha kopjet e autorizimit brenda 15 ditësh nga data e mbarimit të autorizimit të import/eksportit.	D

1.3. Bazat e të dhënave të përbashkëta dhe shërbimet qendrore

Protokolli Shtesë nr. 5 dhe aneksi I ofrojnë bazën ligjore për krijimin e një baze të dhënash të përbashkëta rajonale dhe shërbime qendrore ndërmjet Palëve të CEFTA-s.

Përveç mekanizmave të shkëmbimit pikë më pikë, siç përcaktohen në seksionet 1.1, 1.2 dhe 2.1, ky aneks I përcakton listën e bazave të të dhënave të përbashkëta dhe shërbimet qendrore që do të krijohen gjatë zbatimit të Protokollit Shtesë nr. 5.

Institucionet që do të ofrojnë mbështetje për këto baza të dhënash rajonale dhe shërbimet qendrore janë Sekretariati CEFTA ose *Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal*. Në rast se, *Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal* do të ofrojë mbështetje për bazat e të dhënave rajonale dhe shërbimeve qendrore, *Sekretariati i CEFTA-*

s dhe Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal do të nënshkruajnë një Memorandum për të rregulluar të drejtat dhe detyrimet në lidhje me mbështetjen.

Tabela 1.3.(1). Bazat e të dhënave të përbashkëta

	Baza e të dhënave të përbashkëta	Qëllimi	Të drejtat e hyrjes
1.	Baza e të dhënave të njohura në mënyrë reciproke për OEA-të ⁴ CEFTA	Shpërndarja e informacionit për shoqëritë që mbajnë statusin OEA: - Të dhënat e shoqërisë; - Pala CEFTA që e ka certifikuar autorizimin	Administratat doganore Autoritetet kompetente të përfshira në zhdoganimin e mallrave
2.	Baza e të dhënave për produktet jo të sigurta/të papajtuashme, të identifikuar në tregun CEFTA	Parandalimi i shpërndarjes/i hedhjes në treg të produkteve të pasigurta në tregtinë ndërmjet vendeve të CEFTA-s, të tilla si: 1. Produkte që nuk janë në përputhje me rregulloret teknike; 2. Lista e produkteve që janë në përputhje me rregulloret teknike, por që përbënë rrezik për interesin publik, jetën e njerëzve, kafshëve dhe bimëve; 3. Lista e produkteve të ndaluara për import	Akses i hapur për publikun

Tabela 1.3.(2). Shërbimet qendrore

	Shërbimi qendror	Qëllimi i shërbimit	Të drejtat e hyrjes
1.	Baza e të dhënave rajonale për licencat e lëshuara	Ruajtja e të dhënave për licencën e lëshuar nga autoritetet kompetente dhe laboratorët e certifikuar (mbi bazën e përcaktimeve funksionale dhe teknike të Sistemit të BE-së për Kontrollin e Tregtisë dhe Ekspertimit - TRACES)	Autoritetet për masat sanitare dhe fitosanitare Autoritetet për barrierat teknike ndaj tregtisë

2. Përcaktimi i mënyrave dhe detyrimi për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet autoriteteve doganore në masën e lejuar nga çdo legjislacion kombëtar

2.1. Shkëmbimi i të dhënave në kuadër të konceptit SHESDH⁵ që aktualisht mbështetet nga protokolle dypalëshe (memorandume mirëkuptimi)

Shkëmbimi i të dhënave, mbi bazën e konceptit të shkëmbimit sistematik në mënyrë elektronike të të dhënave, të krijuar më parë, ndërmjet administratave doganore të Palëve të CEFTA-s në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbështeten nga protokolle dypalëshe (memorandume mirëkuptimi). Këto memorandume do të qëndrojnë në fuqi dhe do të vazhdojnë të jenë bazë ligjore për shkëmbimet elektronike të të dhënave që janë krijuar aktualisht nga dogana në doganë.

Përcaktimet e dhëna në aneksin I synojnë të unifikojnë dhe përgjithësojnë përkufizimet e memorandumeve, mbi bazën e formularëve të shërbimeve në bllok të SHESDH-së (që paraqiten në shtojcën II), i cili është miratuar zyrtarisht nga mekanizmi i doganave të lidhura në rrjet global (DRG), iniciativë e Organizatës Botërore të Doganave (OBD).

Duke pasur si qëllim dërgimin e të dhënave para mbërritjes nga deklaratimet doganore të eksportit (nga Pala CEFTA eksportuese te Pala CEFTA importuese) gjatë zbatimit të Protokollit Shtesë nr. 5, çdo Palë CEFTA (autoriteti i saj doganor) do të vendosë lidhje shtesë të sigurta për shkëmbimin e të dhënave me gjithë Palët e tjera CEFTA. Kjo infrastrukturë komunikimi do të përbëjë shtyllën e gjithë shkëmbimit të të dhënave ndërmjet Palëve të CEFTA-s.

2.2. Përshkrimet e hollësishme të grupit të të dhënave:

Tabela më poshtë paraqet listën e zakonshme të të dhënave nga deklaratimet e eksportit që do të shkëmbehen ndërmjet Palëve të CEFTA-s:

Tabela 2.2.(1). Grupi i të dhënave të zakonshme të deklaratës së eksportit

Kutia DAU ⁶	Fusha e të dhënës	Përshkrimi
Kutia A	Numri referencës i DAU-së	Numri referencës i një dokumenti administrativ unik
Kutia 5	Artikujt	Numri total i artikujve
Kutia 22 P1	Monedha e faturës	Kodi i monedhës ISO 4217
Kutia 22 P2	Shuma e faturës	Totali i shumës së faturuar
Kutia 29	Zyra kufitare e doganës	Zyra doganore e daljes (numri i saj i referencës)
Kutia 35	Pesha bruto	Pesha totale bruto
Kutia 54	Vendi i deklarimit	Vendi i depozitimit të deklaratës doganore
Kutia 54	Data e deklarimit	Data e dorëzimit të deklarimit
Kutia 2	Emri i dërguesit	Emri i dërguesit/i shoqërisë
Kutia 2	Identiteti i dërguesit	Dërguesi/numri identifikimit tatimor

⁴ Operator ekonomik i autorizuar.

⁵ Shkëmbim elektronik sistematik i të dhënave, nga anglishtja: *Systematic Electronic Exchange of Data (SEED)*.

⁶ Dokumenti administrativ unik, nga anglishtja: *Single Administrative Document (SAD)*.

Kutia DAU ⁶	Fusha e të dhënës	Përshkrimi
Kutia 19	Konteiner transporti	Nëse transporti është kryer me konteiner (PO/JO)
Kutia 21 P1	Identiteti në kufi i transportuesit	Numri i targës i kamionit (mjetit të transportit)
Kutia 21 P2	Identiteti në kufi i rimorkios	Numri i targës së rimorkios
Kutia 21 P2	Shtetësia në kufi e transportuesit	Shteti i regjistrimit të automjetit
Kutia 25	Mënyra e transportit në kufi	Mënyra e transportit
Kutia 15	Shteti dërgues	Pala CEFTA eksportuese (Kodi ISO ALPHA 2)
Kutia 17	Shteti i destinacionit	Pala CEFTA e destinacionit (Kodi ISO ALPHA 2)
Kutia 31	Përshkrimi	Përshkrimi i mallit
Kutia 32	Artikulli	Numri serisë së artikullit
Kutia 33	Kodi artikullit	Kodi artikullit
Kutia 31	Ambalazhimi i paketave	Numri i paketimeve
Kutia 31	Ambalazhimi i njërive	Numri i njërive

Vendet Palë të CEFTA-s nuk janë të kufizuara të shkëmbejnë vetëm të dhënat e zakonshme të përcaktuara më sipër nga deklarata e eksportit. Palët e CEFTA-s mund të bien dakord që një grup më i madh të dhënash të shkëmbehet në nivel dypalësh.

2.3 Shtrirja gjeografike

Administrata Doganore e Republikës së Moldavisë mund të përfshihet në shkëmbimin SHESDH, në pajtim me përcaktimet e dhëna në shtojcën II. Duke qenë se Republika e Moldavisë nuk ka kufi të përbashkët me Palë të tjera të CEFTA-s, do të aplikohen vetëm përcaktimet në lidhje me shkëmbimin e të dhënave para mbërritjes në SHESDH.

2.4 Fushat e shtrirjes së shkëmbimit të të dhënave ndërmjet administratave doganore

Shkëmbimi i të dhënave në SHESDH ndërmjet administratave doganore mund të zgjerohet duke mbuluar nevojat e biznesit sa më poshtë:

- a) Shkëmbim i të dhënave mbi rezultatet e analizës së riskut dhe kontroleve të dërgesës (arsyet e kryerjes së kontrollit, treguesi i riskut, rezultati i kontrollit);
- b) Shkëmbim i të dhënave për rimbursimin e TVSH-së në kufi;
- c) Shkëmbim i të dhënave për imazhet e skanerit (rezet x) të kamionëve/konteinerëve të kontrolluar;
- d) Shkëmbim i të dhënave për aplikimet për marrjen e masave kundër shkeljeve të të drejtave të pronësisë intelektuale;

3. Njohja reciproke e programeve kombëtare të OEA-ve

Përcaktimet teknike për njohjen reciproke të programeve të OEA-ve shkruhen në bazën e mekanizmit të OBD-së për shërbimet e ofruara në bllok mbi bazën e marrëveshjeve për njohjen reciproke të OEA-ve. Ato paraqiten në shtojcën III të aneksit I.

Në këtë pjesë do të përcaktohen të dhënat e zakonshme (të renditura sipas rendit alfabetik), në lidhje me njohjen reciproke të OEA-ve që do të shkëmbehen ndërmjet Palëve të CEFTA-s:

Tabela 3.1. Fushat e të dhënave për njohjen reciproke të OEA-ve

Fusha e të dhënës	Përcaktimi	Vlerat e fushës; shënime
Pranuar	Statusi i OEA-së në historikun e të dhënave sipas rezultatit	Vlerat: 0 = Refuzuar, 1 = Pranuar
Statusi i certifikatës OEA	Kodi për të dalluar certifikatat aktualisht në fuqi, të pezulluara dhe të revokuara	Vlerat: A = aktuale, P = Pezulluar, R = Revokuar
Lloji i certifikatës OEA	Lloji i certifikatës OEA	Llojet i certifikatës: për t'u përcaktuar nga partnerët
Numri i identifikimit tatimor (NIT) i OEA-së	Identifikuesi unik për operatorin ekonomik të autorizuar, i dhënë nga partneri "miratues" dhe i lidhur me certifikatën përkatëse OEA.	Tregtar OEA "i miratuar", identifikim i vendosur nga partneri "miratues"
NIT "Pseudo"	NIT "pseudo" i vendosur nga partneri "depozitues" për çdo NIT OEA "të miratuar" në rast se partneri "depozitues" nuk mund të përpunojë NIT OEA "të miratuar" që i ka caktuar partneri "miratues"	NIT "pseudo" i caktuar nga partneri "depozitues" për një NIT OEA "të miratuar"
Qyteti	Emri i qytetit të OEA-së	Qyteti
Akronime të kërkesës së të dhënave		K = Kërkuar, O = Opsionale
Akronime të llojit të të dhënave		a = Alfa, n = Numerik, d = e dhënë, do = Data, koha
Data e përfundimit	Është data e përfundimit të periudhës së vlefshmërisë për NIT-in e OEA-së. Së bashku me datën e fillimit, ato ofrojnë panoramën e plotë të vlefshmërisë që NIT AEO-ja ka gjatë ciklit të jetës së tij	Përcakton datën që statusi i certifikatës OEA mbaron efektet e tij. Së bashku me datën e fillimit, ato përcaktojnë përdhën kohore gjatë së cilës statusi i certifikatës OEA është i zbatueshëm. Nëse

		data e mbarimit është bosh, periudha e vlefshmërisë është me afat të pacaktuar
Lloji i ekstraktit	Lloji i ekstraktit të nxjerrë	Vlerat: P = E plotë, N = E ndryshueshme
Emri i plotë	Emri i plotë i OEA-së.	
Kodi i gjuhës	Kodi i gjuhës që identifikon gjuhën/ grupin e shkronjave.	Kodi i gjuhës i përdorur për të përcaktuar gjuhën e përdorur në gjithë informacionin e tekstit (Kodifikimi ISO Alfa 2 - ISO 639).
Mesazhi identifikues	Mesazhi unik identifikues	Identifikues i krijuar me anë algoritmesh GUID
Veprimi	Kodi që bën dallimin ndërmjet të dhënave të krijuara, të përditësuara apo të fshira	Vlerat: K = Krijo, P = Përditëso, F = Fshi
NIT tjetër	Numri i identifikimit kombëtar i përcaktuar	Përdoret në rastet kur partneri ka numër identifikimi që nuk përputhet me modelin e të dhënave të OBD-së
Kodi postar	Kodi postar i OEA-së.	
Lloji i ekstraktit të referencës	Lloji i ekstraktit të nxjerrë në lidhje me mesazhet ekuivalente	Vlerat: P = E plotë, N = E ndryshueshme
Mesazhi identifikues i referencës	Përgjigjja e vetme si mesazh identifikues	Mesazhi unik si identifikues që përdor algoritmin GUID
Numri serial i referencës	Numri i mesazhit rezultues	Identifikon serinë e mesazhit rezultues
Detajet e statusit	Përshkrim i detajeve të statusit	Tekst i lirë deri në 500 shkronja në lidhje me detajet e statusit
Data dhe ora e dërgimit	Data kur e dhëna është dërguar	Data dhe vula e orës kur është dërguar e dhëna
Organizata dërguese	Kodi ISO – 3166 Alfa 2 për partnerin dërgues së të dhënave	
Numri serial	Identifikon shkëmbimin e të dhënave si rezultat i nxjerrjes së ekstraktit	Nëse ky është një ekstrakt i plotë i të dhënave, numri serial përkon me numrin serial të ekstraktit të diferencuar
Emri shkurt	Emri shkurt i OEA-së	Emri shkurt i OEA-së, i kufizuar në shkronja, duke pasur në maksimum 35 shkronjat që paraqiten në modelin e të dhënave të OBD-së
Data e fillimit	Përdoret për të përcaktuar datën e fillimit të periudhës së vlefshmërisë së një TIN OEA. Së bashku me Datën e përfundimit, ato ofrojnë panoramën e plotë të një vlere të caktuar që artikulli i përshkruar mund të ketë gjatë ciklit të jetës së tij	Përcakton datën kur Statusi i certifikatës OEA fillon efektet e tij. Së bashku me Datën e mbarimit, ato përcaktojnë periudhën kohore gjatë së cilës Statusi i certifikatës OEA është i zbatueshëm
Kodi i statusit Kodi	Kodet për raste specifike	Vlerat: E00001 = Hedhja e të dhënave dështoi, ato ekzistojnë paraprakisht, E00002 = Përditësimi dështoi, të dhënat nuk ekzistojnë, W00003 = Fshirja dështoi, të dhënat nuk ekzistojnë, I10001 = Të dhëna të përditësuara, por ndryshimet nuk janë përfshirë
Lloji i statusit	Identifikon llojin e informacionit të statusit	Vlerat: G = Gabim, K = Kujdes, I = Vetëm informacion
Rruga dhe numri	Rruga dhe numri i OEA-së	
Identifikuesi kombëtar i tregtarit	Identifikuesi unik i operatorit ekonomik të autorizuar, i dhënë nga autoriteti kompetent dhe që lidhet me certifikatën përkatëse të OEA-së	
Identifikimi i transaksionit	Elementi teknik bën të mundur grupimin e një sërë operacionesh në një transaksion të përgjithshëm	
Versioni	Elementi teknik tregon versionin e strukturës së mesazhit	

4. Dispozitat përfundimtare

4.1. Pronësia e sistemit të shkëmbimit të të dhënave

Në këtë pjesë do të përcaktohet pronësia e të dhënave pasi sistemi të hyjë në përdorim.

Pas zbatimit të Protokollit Shtesë nr. 5 dhe pasi sistemi për shkëmbimin elektronik të të dhënave të jetë në përdorim:

- Pronësia e të dhënave të ruajtura në bazat e të dhënave SHESDH+, në secilën Palë CEFTA do t'i përkasë Palës CEFTA që ka lidhje me to, e cila duhet të respektojë rregullat për mbrojtjen e të dhënave siç përcaktohet në nenin 11 të Protokollit Shtesë nr. 5;

- Pronari i të dhënave të ruajtura në bazat e të dhënave të përbashkëta dhe shërbimet qendrore do të jetë administrata doganore e Palëve të CEFTA-s.

4.2. Mirëmbajtja e sistemit për shkëmbimin e të dhënave

Në këtë pjesë do të përcaktohet mënyra se si do të organizohet mirëmbajtja pasi sistemi të vihet në përdorim.

Pas zbatimit të Protokollit Shtesë nr. 5 dhe pas vendosjes në punë të sistemit për shkëmbimin elektronik të të dhënave:

- Mirëmbajtja e bazave të të dhënave të përbashkëta dhe shërbimeve qendrore do të jetë përgjegjësi e Sekretariatit të CEFTA-s ose *Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal*. Në rast se, *Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal do të ofrojë mirëmbajtjen e bazave të të dhënave rajonale dhe shërbimeve qendrore, Sekretariati i CEFTA-s dhe Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal do të nënshkruajnë një memorandum mirëkuptimi për të rregulluar të drejtat dhe detyrimet në lidhje me mirëmbajtjen.*

- Mirëmbajtja e pajisjeve harduer dhe aparaturave të komunikimit për lidhjet e komunikimit kombëtar dhe dypalësh (palë më palë) do të jetë përgjegjësi e administratave doganore të Palëve të CEFTA-s ose e një autoriteti kompetent tjetër që ka infrastrukturën e duhur të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Secila nga palët e CEFTA-s do të caktojë ekspertët TIK përgjegjës dhe do të komunikojnë të dhënat e tyre të kontaktit tek ekspertë teknikë të autorizuar të të gjitha Palëve të tjera të CEFTA-s, si dhe institucioneve kombëtare të përfshira në shkëmbimin e të dhënave;

- Përgjegjësia për mirëmbajtjen e shërbimeve për ushqimin automatik dhe/ose gjysmë-automatik të të dhënave në bazat e të dhënave të përbashkëta dhe shërbimet qendrore, do të ndahet ndërmjet secilës Palë individuale të CEFTA-s dhe sekretariat të CEFTA-s ose *Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal*. Në rast se, *Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal do të ofrojë mirëmbajtjen e bazave të të dhënave rajonale dhe shërbimeve qendrore, Sekretariati i CEFTA-s dhe Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal do të nënshkruajnë një memorandum mirëkuptimi për të rregulluar të drejtat dhe detyrimet në lidhje me mirëmbajtjen.*

- Mirëmbajtja e moduleve të programeve softuer për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Palëve të CEFTA-s do të koordinohet për të gjithë rajonin CEFTA;

4.3. Ndryshimi i përcaktimeve të aneksit I

Në këtë pjesë do të përcaktohet mënyra si mund të ndryshohen/të përditësohen përcaktimet teknike (kryesisht ato në lidhje me listën e dokumenteve, grupin e të dhënave të tyre, bazat e të dhënave të zakonshme) pas miratimit të Protokollit Shtesë nr. 5.

Pas miratimit të Protokollit Shtesë nr. 5, përcaktimet e këtij aneksi I mund të ndryshohen përmes strukturave përkatëse të CEFTA-s.

SHTOJCA I SHËRBIMET E OFRUARA NË BLOK PËR THJESHTIMIN/LEHTËSIMIN E INSPEKTIMEVE

Hyrje. Përcaktimet e dhëna në shtojcat e aneksit I të Protokollit Shtesë nr. 5 bazohen në formularin e Organizatës Botërore të Doganave (OBD) për shërbimet e ofruara në bllok (SHB), në veçanti në përmbledhjen e përgjithshme të SHB-ve të nismës së doganave të lidhura në rrjet global (DRG).

QËLLIMI	Dërgimi i të dhënave të certifikatave (vendimeve/miratimeve/licencave) të lëshuara nga autoritetet përkatëse (agjencitë teknike) nga Pala CEFTA eksportuese tek autoritetet përkatëse të Palës CEFTA importuese të mallrave. Autoritetet e Palës CEFTA importuese do të përdorin të dhënat e marra për të: - Kryer paraprakisht një analizë risku dhe masa të tjera analitike (përpara mbërritjes së mallrave); - Përsheptuar procedurat dhe formalitetet për lëshimin e certifikatave të hyrjes dhe/ose importit (vendimet/miratimet/licencat) për aq sa është e mundur.
AVANTAZHI PËR QEVERINË	Parashikohet të kenë përfitime autoritetet qeveritare të Palëve të CEFTA-s, sa më poshtë: - Autoritetet për masat sanitare dhe fitosanitare; - Autoritetet për barrierat teknike ndaj tregtisë;

	- Autoritetet doganore; - Autoritetet e transportit.
AVANTAZHET PËR BIZNESET/ AKTORËT	Avantazhet dhe përfitimet e komunitetit të biznesit: - Përshejtim dhe lehtësim i tregtisë së ligjshme në të gjitha etapat e zhdoganimit; - Procedura zhdoganimit më të parashikueshme dhe transparente;
NIVELI I SUBJEKTEVE	Autoritetet e mëposhtme të Palës CEFTA eksportuese (CPoE) të mallrave do të dërgojnë të dhënat tek autoritetet kompetente të Palës CEFTA importuese (CPoI): - Autoriteti fitosanitar; - Autoriteti veterinar; - Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
NIVELI I GRUPIT TË TË DHËNAVE	Do të shkëmbehen të dhëna nga dokumentet e mëposhtme: - Certifikata Shëndetësore Veterinare për Kafshët e Gjalla; - Certifikata Shëndetësore Veterinare për Produktet me Origjinë Shtazore; - Certifikata Fitosanitare për Eksport; - Certifikata Fitosanitare për Rieksport; - Certifikata e një produkti farmaceutik; - Leje eksporti për grupet e medikamenteve që përmbajnë substanca të kontrolluara: 1. lëndët narkotike; 2. substancat psikotrope; 3. prekursorët; 4. barnat që përmbajnë prekursorë). Aty ku kërkohet, formularët përkatës ndërkombëtarë për llojet e renditura më sipër të dokumenteve do të përdoren si modele. Për sa i përket strukturës së të dhënave, do të përdoren si model versionet më të fundit të modelit të të dhënave të OBD-së, në veçanti paketa e informacionit për shkëmbimin e të dhënave qeveri më qeveri (G2G).
NIVELI I NXITËSIT	Ngjarja që nis qarkullimin e të dhënave: - Momenti i lëshimit të dokumenteve të përcaktuara në nivelin e grupit të të dhënave nga institucionet e autorizuar të Palës CEFTA eksportuese.
NDËRFAQIA/ INTEGRIMI/ KOMUNIKIMI	Lidhja ndërmjet autoriteteve të përfshira të Palëve të CEFTA-s do të përcaktohet si më poshtë vijon: - Rrjeti i shkëmbimit SHESDH+ doganë më doganë (shkëmbimi elektronik sistematik i të dhënave) do të përdoret si shtylla e shkëmbimit të dyanshëm të të dhënave; - Shkëmbimi i informacionit do të kryhet përmes internetit, si dhe përmes rrjeteve virtuale private (VPN); - Autoritetet e mbikëqyrjes fitosanitare, veterinare, të barnave dhe tregut do të krijojnë lidhje me rrjetin SHESDH+ të doganave në nivel kombëtar; - Ndërfaqet ndërmjet sistemeve TI të këtyre institucioneve dhe rrjetit SHESDH të doganave do të ofrojnë: mesazhe teknike në gjuhën <i>Extensible Markup (XML)</i> dhe përcaktimet e shërbimeve në rrjet në gjuhën e shërbimeve në rrjet (WSDL); - Siguria e të gjitha mesazheve të shkëmbyera do të sigurohet shtesë me anë të një çelësi kodimi asimetrik (duke përdorur certifikatat e sigurisë digjitale, të lëshuara nga autoritetet e kualifikuara).

SHTOJCA II

MEKANIZMI I SHËRBIMEVE NË BLOK NË PLATFORMËN SHESDH

QËLLIMI	Shkëmbimi elektronik i të dhënave në mënyrë sistematike dhe automatike nga dokumentet doganore (deklaratat doganore të eksportit, importit dhe transitit, Carnet TIR (një dokument transporti ndërkombëtar që mundëson transportin e mallrave nga zyra doganore e nisjes për në zyrën doganore të destinacionit) dhe ATA, dokumentacioni përcjellës për procedurën e thjeshtuar, fatura, përfshirë të dhënat në lidhje me pikat e kamionëve bosh) ndërmjet administratave doganore të Palëve të CEFTA-s, për qëllimet e mëposhtme: - Për të lehtësuar dërgimin e të dhënave përpara mbërritjes, në momentin e fillimit të procedurës doganore në Palën CEFTA partnere (nga zyra doganore e dërgimit - COoDep), me objektivat e mëposhtëm: - Përshejtimi i procedurave doganore dhe i formaliteteve të inspektimit (që lidhen me kodin(et) tarifor(e) përkatës në pikën e hyrjes në territorin doganor të Palës CEFTA importuese (ose transit); - Përshejtimi i procedurave doganore dhe të inspektimit për zhdoganimin në zyrë doganore të Palës CEFTA importuese; - Analiza e të dhënave përpara mbërritjes duke përdorur kriteret e paracaktuara të riskut dhe dërgimin e alarmeve të zyrarët e autorizuar. - Për të verifikuar saktësinë e deklaratave të paraqitura në dy administratat doganore fqinje. Thënë ndryshe, për të bërë të mundur kryqëzimin automatik (lidhjen dhe krahasimin) e të dhënave nga dokumentet doganore të paraqitura në dy vende fqinje Palë të CEFTA-s (zyra doganore e daljes (COoEx) dhe zyra doganore e hyrjes (COoEn).
AVANTAZHI PËR QEVERINË	Avantazhet dhe përfitimet për administratat doganore të Palëve të CEFTA-s: - Parandalimi i kontrabandës dhe forcimi i luftës kundër krimit të organizuar; - Parandalimi i nënvlerësimit: rritja e mbledhjes së detyrimeve doganore;

	- Parandalimi i korrupsionit; - Përmirësimi i “analizës së riskut” të të dhënave që vijnë përpara mbërritjes së mallrave; - Përmirësimi i kapacitetit të përgjithshëm teknik të administratave doganore të Palëve të CEFTA-s; - Nxitja dhe përmirësimi i komunikimit dhe i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qeveritare të Palëve të CEFTA-s; - Rritja e efikasitetit në punë e nëpunësve të doganave.
AVANTAZHET PËR BIZNESET/ AKTORËT	Avantazhet dhe përfitimet për operatorët ekonomikë: - Përsheptimi i procedurave doganore dhe lehtësimi i tregtisë së ligjshme.
KUADRI LIGJOR DHE PAJTUESHMËRIA	- Protokoll i Shtesë nr. 5 i CEFTA-s; - Marrëveshjet për dhënien e asistencës reciproke ndaj administratave doganore (CMAAA); - Protokollet dypalëshe për shkëmbimin elektronik të të dhënave (që përcaktojnë, ndër të tjera, fushën e veprimit dypalësh të të dhënave që do të shkëmbehen); - Shkëmbimi i informacionit është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe të dhënat do të ruhen të siguruar në sistemet përkatëse.
NIVELI I SUBJEKTEVE	Administratat doganore të Palëve të CEFTA-s: Administratat doganore të eksportit, transitit dhe importit luajnë këto role: - Administrata dërguese (AoD): - Ofron të dhënat PËRPARA MBËRRITJES dhe TË DALJES; - Merr të dhëna automatike që përputhen me rezultatet nga ana tjetër (HYRJA) në pikën e kalimit. - Administrata marrëse (AoA): - Ofron të dhënat e HYRJES; - Merr të dhëna automatike për rezultatet që përputhen; - Merr njoftimin e alarmit për mbërritjen e të dhënave PËRPARA MBËRRITJES dhe për kriteret e përcaktuara të riskut.
NIVELI I RREGULLAVE PËR BIZNESIN	1. Përsheptimi i procedurave të hyrjes dhe të importit: - Në momentin e zhdoganimit të EKSPORTIT në administratën e doganore dërguese (AOD), të dhënat e deklarës së eksportit të pranuar do të dërgohet përmes sistemit SHESDH++ të administratës marrëse (AOA) dhe përdoren për: - Përsheptim të formaliteteve doganore në pikën e hyrjes; - Përsheptim të dhënies së lejeve të nevojshme për hyrjen (siç përcaktohen në legjislacionin e tarifave) nga ana e marrësit përgjegjës. - Përsheptim i zhdoganimit importues në destinacionin përfundimtar të mallrave. 2. Analiza e riskut dhe alarmi: - Në fillim të procedurës doganore në administratën dërguese (AOD), të dhënat e dokumentit doganor të pranuar do të dërgohen përmes sistemit SHESDH+ të administratës marrëse (AOA) dhe do të përdoren për të kryer analizën e riskut dhe dhënien e alarmeve; - Nëse Pala CEFTA marrëse është vend transiti CEFTA, SPDD-ja do të dërgojë informacion e deklarës kombëtare të transitit te sistemi Sistemi SHESDH+ dhe përmes sistemit SHESDH+ të dhënat do t'i dërgohen Palës CEFTA fqinje si të dhëna PËRPARA MBËRRITJES për t'u përdorur për kryerjen e analizës së riskut dhe alarmet. 3. Përputhshmëri automatike e të dhënave: - Kur mallrat largohen nga një Palë CEFTA A dhe hyjnë në një Palë CEFTA B, mesazhet do të përpunohen sipas rregullave të mëposhtme: - Pala CEFTA A vepron si administratë dërguese (AOD) dhe sistemi i përpunimit të deklarës doganore (SPDD) e dërgon informacionin e deklarës kombëtare të eksportit përmes sistemit SHESDH+ te Pala CEFTA fqinje B, duke vepruar si administratë marrëse (AOA); - Pala CEFTA B vepron si administratë marrëse (AOA) dhe SPDD-ja dërgon informacionin e deklarës kombëtare të importit ose transitit te Sistemi SHESDH+, ku përfundon edhe procedura për kryqëzimit automatike të të dhënave.
NIVELI I GRUPIT TË TË DHËNAVE	SHESDH+ do të mbështesë shkëmbimin e të dhënave që mbajnë dokumentet doganore si më poshtë: 1. SHESDH+ njofton për deklaratat e transitit, si dhe sistemi i ri elektronik për transitin e BE-së (SIET⁷) njofton nga domeni kombëtar dhe i përbashkët: modeli i të dhënave bazohet në modelin e të dhënave të OBD-së (Organizatës Botërore të Doganave) dhe sistemi i ri SIET i BE-së; 2. SHESDH+ njofton për deklaratat e eksportit: modeli i të dhënave bazohet në modelin e të dhënave të OBD-së dhe Sistemin e Kontrollit të Eksportit (SKE) të BE-së; 3. SHESDH+ njofton për deklaratat e importit: modeli i të dhënave bazohet në modelin e të dhënave të OBD-së dhe Sistemin e Kontrollit të Importit (SKI) të BE-së; ky mesazh do të përdoret për kryqëzimin e të dhënave dhe do t'i transmetohet Palës CEFTA fqinje; 4. SHESDH+ njofton për dokumentet TIR Carnet: modeli i të dhënave bazohet në modelin e të

⁷ Nga anglishtja: *European Union New Computerised Transit System- NCTS*.

	dhënave të Komitetit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) dhe e TIR-së; 5. SHESDH+ njofton për dokumentet ATA Carnet; 6. SHESDH+ njofton për procedurën e thjeshtuar të dokumentit shoqërues (fatura); 7. SHESDH+ njofton për kalimin e kamionëve bosh,
NIVELI I NËXTËS	Ngjarjet që fillojnë qarkullimin e të dhënave: 1. Para mbërritjes: Fillimi i procedurës doganore në administratën dërguese. Në momentin e pranimit të dokumentit doganor, dokumenti administrativ unik i eksportit (DAU), Transit DAU, TIR Carnet, dokumenti shoqërues i procedurës së thjeshtuar. Këto të dhëna do të përdoren për përshejtimin e procedurave doganave dhe inspektimit, si dhe për kryerjen e analizës së riskut/krijimin e alarmeve. 2. Dalja: Përfundimi i procedurës doganore në administratën dërguese. Në momentin e konfirmimit të ardhjes së kamionit në zyrën doganore të daljes në administratën fqinje dhe verifikimi i kamionit që del nga Pala CEFTA fqinje. Këto të dhëna do të përdoren si referencë për kryqëzimin automatik të të dhënave. 3. Hyrja: Fillimi i procedurës doganore në administratën marrëse. Në momentin e pranimit të dokumenteve doganore në zyrën doganore të hyrjes; të dhëna do të përdoren për krahasimin automatik me të dhënat e referencës të pranuar nga administrata fqinje dërguese (AOD).
NDËRFAQJA	Mesazhet teknike që shoqërojnë grupin e të dhënave dhe niveli i nxitjes bazohen në dokumentet doganore sa më poshtë: - Mesazhet DAU Transit; - Mesazhet DAU Eksport; - Mesazhet DAU Import; - Mesazhet TIR Carnets; - Mesazhet ATA Carnets; - Dokumentet shoqëruese të procedurës së thjeshtuar; - Të dhënat e kamionit bosh; Mesazhet teknike përcaktohen nga skemat e gjuhës <i>Extensible Markup</i> (XML) dhe përkufizimi i shërbimeve në rrjet në gjuhën e shërbimeve në rrjet (WSDL).
INTEGRIMI	Sistemi doganave SHESDH+ ka një tipologji nga “pika në shumë pika” që do të thotë se secila administratë doganore pjesëmarrëse do të ketë pikën e saj fundore në SHESDH+, të lidhur me pikat përkatëse SHESDH+ të të gjitha Palëve të tjera CEFTA. Pika SHESDH+ duhet të jetë e integruar plotësisht me infrastrukturën TI kombëtare të doganave, si dhe të jetë e lidhur me aplikime të tjera kombëtare përmes portalit të shërbimeve ndaj sipërmarrjeve (ESB) dhe ndërfaqes standarde në WSDL.
KOMUNIKIMI	Shkëmbimi i informacionit do të kryhet përmes internetit dhe përmes rrjeteve virtuale private (VPN). Siguria e mesazheve do të sigurohet me anë të një çelësi kodimi asimetrik (duke përdorur certifikatat e sigurisë digjitale, të lëshuara nga autoritetet e kualifikuara). Pikat e SHESDH+ duhet të ndërtohen si arkitekturë e orientuar për shërbimin (SOA), si dhe të zbatohen sipas teknologjisë dhe standardeve të shërbimeve në rrjet (WS). Ndërfaqja(et) duhet të mbështeten në arkitekturën e softuerit të portalit të shërbimeve ndaj sipërmarrjeve (ESB) për të lejuar konfigurimin e ndërlidhjes.

SHTOJCA III

MEKANIZMI I SHËRBIMEVE NË BLOK PËR NJOHJEN RECIPROKE TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË AUTORIZUAR

QËLLIMI	- Të specifikojë procesin që rregullon bashkëveprimin e informacionit ndërmjet administratave doganore të Palëve të CEFTA-s (partnerët) dhe tregtarëve të përfshirë, që nënshkruajnë një marrëveshje për njohjen reciproke (MNJR) të OEA-ve; - Të mundësojë që secili prej partnerëve t'u japë përfitime OEA-ve të të gjitha vendeve të tjera Palë të CEFTA-s, ku si legjislacioni dhe zbatimi i programit kombëtar është plotësisht në përputhje me legjislacionin e BE-së,
AVANTAZHI PËR QEVERINË	- Sigurimi i zbatimit automatik dhe koherent i një MNJR-je dypalëshe për OEA-të për të gjitha Palët e CEFTA-s, duke bërë të mundur që të përftohen të gjitha përfitimet e parashikuara përgjatë gjithë gjurmës gjeografike të MNJR-së dypalëshe për OEA-të (kontroll më i mirë i objekti, si rezultat i drejtpërdrejtë i analizave të riskut më efikase që kryhen në mënyrë automatike); - Kostoja e ulët për lidhjen e MNJR-ve dypalëshe për OEA-të me mundësi të lartë për ripërdorimin dhe, për rrjedhojë, uljen e kostove për zbatimin e TI-së.
AVANTAZHET PËR BIZNESET/ AKTORËT	- Transparenca dhe parashikueshmëri e përfitimeve që palët CEFTA iu japin OEA-ve; - Sigurohet që Palët e CEFTA-s të angazhohen për zbatimin me sukses të marrëveshjeve bilaterale për OEA-të dhe të ofrojnë përfitimet për OEA-të e njohura (lehtësimi, ulja e pikëve të riskut, ulja e kontrollit në eksport dhe import, ulja e kohës së zhdoganimit) në mënyrë sistematike dhe të parashikueshme; - Bën transparent numrin e identifikimit të tregtarit (NIT) i cili duhet të përdoret në lidhje me çdo Palë të CEFTA-s për të siguruar njohjen e statusit të tyre si OEA.

KUADRI LIGJOR DHE PAJTUESHMËRIA	- Kuadri ligjor, Protokolli Shtesë nr. 5, aneksi teknik dhe MNJR-ja dypalëshe për OEA-të ndërmjet partnerëve; - Pajtueshmëria. Palët e CEFTA-s duhet të garantojnë se informacioni i OEA-ve i shkëmbyer, si dhe të gjitha të dhënat që lidhen me to të jenë në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave të secilës Palë; që të dhënat të ruhen të sigurt në sistemet përkatëse dhe të jenë të sinkronizuara në mbarë sistemet TI të Palëve CEFTA të përfshira. Vënia në dispozicion e informacionit të OEA-ve është i përcaktuar dhe janë të përcaktuara masat që duhen marrë në rast se nuk ka informacion për OEA-të të disponueshëm për përpunimin e një njoftimi doganor ose deklarate doganore.
NIVELI I SUBJEKTEVE	<i>Partner</i> i referohet Palës CEFTA kontaktuese (administratës së saj doganore) në MNJR dypalëshe për OEA-të. Vlen të theksohet se çdo partner do të veprojë në dy role të ndryshme: - Rol “miratues”, si partner “miratues” që i cakton OEA-së statusin e tregtarit, kryen rivlerësimin dhe vlerësimin e këtij OEA-ja. - Rol “depozitues”, si partner “depozitues” që përpunon një njoftim/ deklaram të depozituar në sistemin e tij të doganave nga një tregtar. <i>Tregtar</i> i referohet operatorëve ekonomikë që luajnë një rol aktiv mbështetës në shkëmbimin e informacionit sipas procesit të MNJR-së dypalëshe për OEA-të. Tregtari merr pjesë me dy role në procesin MNJR-së dypalëshe për OEA-të: - “OEA”, si tregtar i certifikuar si OEA nga partneri “miratues”; - Tregtari “depozitues”, si tregtari që ka depozituar një njoftim/deklaram te partneri “depozitues”, duke iu referuar statusit të tij si OEA dhe statusit OEA të partnerëve të tij. Procesi MNJR dypalëshe për OEA-të projektton shkëmbimin e informacioni ndërmjet partnerëve. Të dyja rolet e tregtarit përfshihen për të ilustruar procesin nga pika fundore në pikën fundore. Megjithatë duhet të theksohet se shtylla e parë mbulon ndërveprimet doganë më doganë.
NIVELI I RREGULLAVE PËR BIZNESIN	Përfshin një numër të detajuar rregullash në lidhje me sa më poshtë: - pikat e kontaktit ndërmjet partnerëve (Palë të CEFTA-s); - Kërkesat për: - Informacionin e OEA-së; - Tregtari si një nga pjesëmarrësit mbështetës të procesit të biznesit nga pika fundore në pikën fundore; - Sistemet e transaksioneve të doganave te partneri “depozitues”; - Sistemet e analizës së riskut te partneri “depozitues”; - Menaxhimin e identitetit të OEA-së dhe, në veçanti, procesi i vendosjes së një pseudoemri nga partneri “depozitues”; - Natyrën dhe shpeshtësinë e shkëmbimit të të dhënave, kërkesat e monitorimit dhe statistikore. Pajtueshmëria e të gjithë partnerëve për MNJR dypalëshe për OEA-të me standardin e OBD-së për strukturën e NIT-së është një mundësi madhore për thjeshtësimin e procedurave.
NIVELI I GRUPIT TË TË DHËNAVE	MNJR-të e OEA-së mbështeten në shkëmbimin e dy mesazheve funksionale: - Informacion i OEA-së, “miratuar”; - NIT “pseudo” ndërmjet partnerit “miratues” dhe partnerit “depozitues”.
NIVELI I NXTËSIT	Marrëveshjet dypalëshe për OEA-të ofrojnë tri variante për paraqitjen e operacioneve ndërmjet partnerëve sipas kriterëve të mëposhtme: - Nëse është ose jo e nevojshme që partneri “depozitues” të caktojë një NIT “pseudo” (i sinjalizuar nga struktura jo e rregullt e shifrave në një NIT ndërmjet partnerëve); - Në rastin e strukturave të harmonizuara të NIT-eve ndërmjet partnerëve, një partner “depozitues” mund të zgjedhë “tërheq” (në vend të “shty”) si mënyrë për të marrë qasje në informacionin e OEA-së nga partneri “miratues”. Këto tri opsione janë: - “Shty” informacionin OEA të “miratuar” dhe “shty” mbrapsht NIT “pseudo” ndërmjet partnerit “miratues” dhe partnerit “depozitues”, për ato raste që partnerët kanë NIT jo të harmonizuar; - “Shty” OEA e “miratuar” nga partneri “miratues” te partneri “depozitues” kur partnerët kanë NIT të harmonizuar; - “Tërhiq” informacionin e OEA-së së “miratuar” nga ana e partnerit “depozitues” prej partnerit “miratues”, i cili kërkon harmonizimin e një NIT-je.
NDËRFAQJA	Marrëveshja dypalëshe për OEA-të përcakton 4 mesazhe që lidhen me tri opsionet e mëposhtme të nivelit të nxitjes: - Informacion i OEA-së së “miratuar” dërgohet nga partneri “miratues” dhe NIT “pseudo” kthehet nga partneri “depozitues”, për ato raste që partnerët janë NIT jo të harmonizuar; - Kur partnerët kanë NIT të harmonizuar, OEA-ja e “miratuar” dërgohet nga partneri “miratues” te partneri “depozitues”; - Partneri “depozitues” merr drejtpërdrejt informacion për OEA-në e “miratuar” nga partneri “miratues”. Ofron, gjithashtu, mesazhe teknike në skemat e gjuhës <i>Extensible Markup (XML)</i> dhe përkufizimin e shërbimeve në rrjet në gjuhën e shërbimeve në rrjet (WSDL).
INTEGRIMI	Shtresa e integritetit duhet të profilizohet nga secili partner i MNJN-së Bilaterale të OEA-së. Kjo përfshin rastin e biznesit për profilizimin kombëtar, përdorimin e informacionit të OEA-së për vlerësimin e riskut të njoftimit/të deklaratës dhe dispozitat e brendshme për identifikimin e OEA-

	së. Gjithashtu përcakton kërkesën për disponueshmërinë e të dhënave të shkëmbyera, jep një tregues të volumeve të mundshme të të dhënave, si dhe të kërkesave për përputhshmërinë dhe infrastrukturën.
KOMUNIKIMI	Shkëmbimi i informacioneve bëhet në internet. Siguria e shkëmbimeve bëhet e mundur përmes formimit të lidhjeve mes Rrjeteve Private Virtuale (VPN) dhe kodimit me anë të certifikatave të sigurisë.

ANEKSI II

MATRICA E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT TË NËNSHKRUAR MIDIS AUTORITETEVE DOGANORE DHE AUTORITETEVE KOMPETENTE PËR SHKËMBIMIN ELEKTRONIK TË TË DHËNAVE

	Autoriteti Veterinar	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	Autoriteti Kombëtar Fitosanitar	Autoriteti Kombëtar për Produktet Farmaceutike	Autoriteti Kombëtar i Transportit	Autoriteti Kombëtar i Inspektimit Teknik	Policia e Shtetit
Administrata doganore	DS DA						

DS: Data e nënshkrimit

DA: Data e aplikimit

ANEKSI III
OPERATORI EKONOMIK I AUTORIZUAR

TITULLI I
DHËNIA E STATUSIT TË OPERATORIT EKONOMIK TË AUTORIZUAR NË NIVEL
KOMBËTAR NGA SECILA PALË
E CEFTA-s

Neni 1

Aplikimi dhe autorizimi

1. Një operator ekonomik i cili është krijuar në Palët e CEFTA-s dhe i cili plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 2 të këtij aneksi mund të aplikojë për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar.

Autoritetet doganore, pas konsultimeve me autoritetet e tjera kompetente, nëse është e nevojshme, japin këtë status, i cili është subjekt i monitorimit.

2. Statusi i operatorit ekonomik të autorizuar përbëhet nga llojet e mëposhtme të autorizimeve:

a) Autorizimi i operatorit ekonomik të autorizuar për thjeshtësimet doganore, të cilat mundësojnë mbajtësin që të përfitojë nga thjeshtësime të caktuara në përputhje me legjislacionin doganor (OEAD - Thjeshtësimet doganore); ose

b) Autorizimi i operatorit ekonomik të autorizuar për sigurinë që i jep të drejtë mbajtësit të lehtësirave që lidhen me sigurinë (OEAS - Siguria).

a) 1. Të dyja llojet e autorizimeve, referuar në paragrafin 2, mund të mbahen në të njëjtën kohë (OEAP - Thjeshtësimet/siguria doganore).

Kur një aplikant ka të drejtë të marrë si autorizimin OEAD dhe atë OEAS, autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit lëshon një autorizim të kombinuar.

Neni 2

Dhënia e statusit

1. Kriteret për dhënien e statusit të operatorit ekonomik të autorizuar janë si më poshtë:

a) Mungesa e çdo shkeljeje të rëndë apo shkeljeve të përsëritura të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore, duke përfshirë mungesën e veprave penale të rënda që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikantit;

b) Demonstrimi nga ana e aplikantit i një niveli të lartë kontrolli të operacioneve të tij ose të saj dhe të qarkullimit të mallrave, përmes një sistemi të menaxhimit tregtar dhe, sipas rastit, edhe të të dhënave të transportit, gjë që lejon kryerjen e kontrolleve të përshtatshme doganore;

c) Aftësia paguese financiare, e cila do të konsiderohet se është vërtetuar kur aplikanti ka gjendje të mirë financiare, që e mundëson atë për të përmbushur angazhimet e tij ose të saj, duke pasur parasysh karakteristikat e llojit të aktivitetit të biznesit në fjalë;

d) Në lidhje me autorizimin e përmendur në pikën “a”, të nenit 1(2) të këtij aneksi, standardet praktike të kompetencës apo të kualifikimeve profesionale që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin e kryer; dhe

e) Në lidhje me autorizimin e përmendur në pikën “b”, të nenit 1(2) të këtij aneksi, standardet përkatëse të sigurisë, të cilat do të konsiderohen se janë plotësuar kur aplikanti të demonstrojë se ai ose ajo zbaton masat e duhura për të garantuar sigurinë e zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit, duke përfshirë në zonat e integritetit fizik dhe kontrolleve të aksesit, proceset logjistike dhe trajtimin e llojeve të veçanta të mallrave, personelin dhe identifikimin e partnerëve të tij ose të saj të biznesit.

2. Secila palë e CEFTA-s përcakton procedurat për të kërkuar dhe për të dhënë statusin e operatorit ekonomik të autorizuar dhe efektet ligjore të këtij statusi.

a) 3. Autoritetet doganore monitorojnë kushtet dhe kriteret që duhen plotësuar nga mbajtësi i autorizimit të OEA-së. Gjithashtu, ato monitorojnë përputhjen me detyrimet që rrjedhin nga autorizimi i OEA-së. Kur OEA-ja është krijuar për më pak se tre vjet, autoritetet doganore e monitorojnë atë nga afër gjatë vitit të parë pas dhënies së statusit të OEA-së.

Neni 3

Kriteret e përputhshmërisë

1. Kur aplikanti është person fizik, kriteret e përcaktuara në nenin 2(1a) të këtij aneksi do të konsiderohen se janë përmbushur, nëse gjatë 3 viteve të fundit, aplikanti dhe kur është e mundur punonjësi i ngarkuar për çështjet doganore të aplikantit, nuk kanë kryer asnjë shkelje apo shkelje të përsëritura të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore dhe nuk kanë rekorde të veprave të rënda penale që lidhen me aktivitetin e tyre ekonomik.

Kur aplikanti nuk është person fizik, kriteret e përcaktuara në nenin 2(1a) të këtij aneksi do të konsiderohen se janë përmbushur, nëse gjatë 3 viteve të fundit, asnjë nga personat në vijim nuk kanë kryer ndonjë shkelje apo shkelje të përsëritura të legjislacionit doganor dhe rregullave tatimore dhe nuk kanë rekorde të veprave të rënda penale që lidhen me aktivitetin e tyre ekonomik:

- a) aplikanti;
- b) personi që drejton biznesin e aplikantit ose që ushtron kontroll mbi stafin e tij drejtues;
- c) punonjësi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikantit.

2. Megjithatë, kriteri i referuar në nenin 2(1a) të këtij aneksi mund të gjykohet se është përmbushur kur autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit konsideron se një shkelje e kryer është me rëndësi të vogël, në raport me numrin dhe madhësinë e operacioneve të lidhura me të dhe autoriteti doganor nuk ka asnjë dyshim për sa i përket parimit të mirëbesimit të aplikantit.

3. Kur personi i përmendur në paragrafin 1(b) është vendosur apo ka vendbanimin në një vend të tretë, autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit vlerëson përmbushjen e kriterëve të referuara në nenin 2(1a) të këtij aneksi mbi bazën e të dhënave dhe informacioneve që janë në dispozicion për të.

4. Kur aplikanti është krijuar për më pak se 3 vjet, autoriteti doganor kompetent për marrjen e vendimit vlerëson përmbushjen e kriterëve të referuara në nenin 2(1a) të këtij aneksi, mbi bazën e të dhënave dhe informacioneve që janë në dispozicion për të.

Neni 4

Sistemi i kënaqshëm i menaxhimit tregtar dhe i të dhënave të transportit

1. Kriteri i përcaktuar në nenin 2(1b) të këtij aneksi do të konsiderohet se është përmbushur nëse janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Aplikanti mban një sistem kontabiliteti i cili është në përputhje me parimet e përgjithshme të pranura të kontabilitetit të zbatuara në shtetin anëtar ku mbahen llogaritë, lejon kontrollin doganor të bazuar në auditim dhe mban një regjistër historik të të dhënave që sigurojnë ndjekjen e auditimit nga momenti që të dhënat futen në dosje;

b) Të dhënat që mbahen nga aplikanti për qëllime doganore integrohen në sistemin e kontabilitetit të aplikantit ose lejohen kontrole nga burime të ndryshme të informacionit, të cilat do të realizohen përmes sistemit të kontabilitetit;

c) Aplikanti lejon autoritetin doganor të ketë akses fizik në sistemet e tij të kontabilitetit dhe, kur është e mundur, në të dhënat e tij tregtare dhe të transportit;

d) Aplikanti lejon autoritetin doganor të ketë akses elektronik në sistemet e tij të kontabilitetit dhe, kur është e mundur, në të dhënat e tij tregtare dhe të transportit kur këto sisteme apo të dhëna mbahen

në mënyrë elektronike;

e) Aplikanti ka një sistem logjistik i cili identifikon mallrat si mallra vendëse ose të huaja dhe tregon, sipas rastit, vendndodhjen e tyre;

f) Aplikanti ka një organizim administrativ i cili korrespondon me llojin dhe madhësinë e biznesit dhe i cili është i përshtatshëm për menaxhimin e qarkullimit të mallrave dhe ka kontrole të brendshme që janë në gjendje për të bërë parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve, si dhe parandalimin dhe zbulimin e transaksioneve të paligjshme ose të parregullta;

g) Sipas rastit, aplikanti ka procedura të kënaqshme në vend për trajtimin e licencave dhe autorizimeve të dhëna, në përputhje me masat e politikave tregtare ose në lidhje me tregtinë e produkteve bujqësore;

h) Aplikanti ka procedura të kënaqshme në vend për arkivimin e të dhënave dhe informacioneve të tij dhe për mbrojtjen ndaj humbjes së informacioneve;

i) Aplikanti siguron se punonjësit përkatës janë udhëzuar për të informuar autoritetet doganore sa herë që zbulohen vështirësi lidhur me përputhshmërinë dhe përcakton procedurat për informimin e autoriteteve doganore mbi vështirësi të tilla;

j) Aplikanti ka masat e duhura të sigurisë në vend për të mbrojtur sistemin kompjuterik të aplikantit nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe për të siguruar dokumentacionin e aplikantit;

k) Sipas rastit, aplikanti ka procedura të kënaqshme në vend për trajtimin e licencave të importit dhe të eksportit që lidhen me ndalimet dhe kufizimet, duke përfshirë masat për dallimin e mallrave që i nënshtrohen ndalimeve dhe kufizimeve nga mallrat dhe masat e tjera për të siguruar përputhshmërinë me këto ndalime dhe kufizime.

2. Kur aplikanti aplikon vetëm për një autorizim si operator ekonomik i autorizuar për sigurinë, referuar në nenin 1(2b) të këtij aneksi, kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1(e) nuk zbatohen.

Neni 5

Aftësia paguese financiare

1. Kriteri i përcaktuar në nenin 2(1c) të këtij aneksi konsiderohet se është përmbushur kur aplikanti vepron në përputhje me sa më poshtë:

a) Aplikanti nuk është subjekt i procedurave të falimentimit;

b) Gjatë 3 viteve të fundit para dorëzimit të aplikimit, aplikanti ka përmbushur detyrimet e tij financiare për pagesat e detyrimeve doganore dhe të gjitha detyrimet, taksat ose pagesat e tjera që janë mbledhur për importin ose eksportin e mallrave apo në lidhje me to;

c) Aplikanti demonstroi, në bazë të të dhënave dhe informacioneve në dispozicion për 3 vitet e fundit para dorëzimit të aplikimit, se ka një gjendje të mjaftueshme financiare për të plotësuar detyrimet e tij dhe për të përmbushur angazhimet e tij, duke pasur parasysh llojin dhe volumin e aktivitetit të biznesit, duke përfshirë faktin se nuk ka asete neto negative, përveç rasteve kur ato mund të mbulohen.

2. Nëse aplikanti është krijuar për një periudhë prej më pak se 3 vjetësh, aftësia e tij paguese financiare referuar në nenin 2(1c) të këtij aneksi kontrollohet në bazë të regjistrave dhe informacioneve që janë në dispozicion.

Neni 6

Standardet praktike të kualifikimeve të kompetencave ose ato profesionale

1. Kriteri i përcaktuar në nenin 2(1d) të këtij aneksi konsiderohet i përmbushur nëse është plotësuar ndonjë nga kushtet në vijim:

a) Aplikanti ose personi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikantit vepron në përputhje me një nga standardet e mëposhtme të kompetencës:

i) Eksperiencë e provuar praktike për një periudhë prej minimumi 3 vjetësh në çështjet doganore;

ii) Standard të cilësisë, në lidhje me çështjet doganore, miratuar nga një organ evropian standardizimi;

b) Aplikanti ose personi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikantit ka përfunduar me sukses trajnimin që mbulon legjislacionin doganor, në përputhje dhe në lidhje me masën e përfshirjes së tij në aktivitetet doganore, ofruar nga një prej treguesve në vijim:

i) Një autoritet doganor i një Pale të CEFTA-s;

ii) Një institucion shkollor i njohur, me qëllim sigurimin e një kualifikimi të tillë nga autoritetet doganore ose nga një organ i një Pale të CEFTA-s përgjegjës për trajnimin profesional;

iii) Një shoqatë profesionale ose tregtare e njohur nga autoritetet doganore të Palës së CEFTA-s ose e akredituar në vendin e Palës së CEFTA-s, me qëllim sigurimin e një kualifikimi të tillë.

2. Kur personi i ngarkuar me çështjet doganore të aplikantit është person i kontraktuar, kriteri i përcaktuar në nenin 2(d) të këtij aneksi konsiderohet se është përmbushur nëse personi i kontraktuar është operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësimet doganore të referuara në nenin 1(2a) të këtij aneksi.

Neni 7

Standardet e sigurisë

1. Kriteri i përcaktuar në nenin 2(d) të këtij aneksi konsiderohet se është përmbushur nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Ndërtesat që do të përdoren për operacionet në lidhje me autorizimin OEAS sigurojnë mbrojtje kundër ndërhyrjeve të paligjshme dhe janë ndërtuar prej materialesh që i rezistojnë hyrjes së paligjshme;

b) Ekzistojnë masa të përshtatshme për parandalimin e aksesit të paautorizuar në zyra, zona transporti, porte ngarkimi, zona e ngarkesave dhe vende të tjera përkatëse;

c) Janë marrë masat për trajtimin e mallrave të cilat përfshijnë mbrojtjen kundër futjes ose shkëmbimit të paautorizuar, keqtrajtimit të mallrave dhe kundër falsifikimit me njësitë e ngarkesave;

d) Aplikanti ka marrë masat që lejojnë për të identifikuar në mënyrë të qartë partnerët e tij të biznesit dhe për të siguruar, përmes zbatimit të marrëveshjeve përkatëse kontraktuale apo masave të tjera të përshtatshme, në përputhje me modelin e biznesit të aplikantit, se këto partnerë biznesesh garantojnë sigurinë e pjesës së tyre të zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit;

e) Aplikanti kryen në masën që ligji vendës lejon, ekzaminimin e sigurisë për punonjësit e mundshëm që punojnë në pozicione të ndjeshme të sigurisë dhe kryen kontrole të kualifikimeve të punonjësve aktualë në pozicione të tilla periodikisht dhe kur rrethanat e kërkojnë një gjë të tillë;

f) Aplikanti ka procedurat e përshtatshme të sigurisë në vend për të gjithë ofruesit e shërbimeve të jashtme të kontraktuar;

g) Aplikanti siguron se stafi i tij i pajisur me përgjegjësitë përkatëse për çështje të sigurisë merr pjesë rregullisht në programet për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për çështje të tilla sigurie;

h) Aplikanti ka caktuar një person kontakti kompetent për çështje që lidhen me sigurinë.

2. Kur aplikanti është mbajtës i një certifikate sigurie të lëshuar në bazë të një konvente ndërkombëtare ose të një Standardi Ndërko-mbëtar të një Organizate Ndërkombëtare për Standardizim, ose të një standardi evropian të një organi evropian standardizimi, këto certifikata do të merren parasysh në rastin kur kontrollohet përputhshmëria me kriteret e përcaktuara në nenin 2(e) të këtij aneksi.

Kriteret do të konsiderohen se janë plotësuar në masën që është përcaktuar se kriteret për lëshimin e certifikatës janë të njëjta ose ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 2(e) të këtij aneksi.

3. Kur aplikanti është agjent rregullues (transportues ajror, agjent, transportues mallrash apo ndonjë subjekt tjetër, i cili siguron kontrollin e sigurisë lidhur me ngarkesën ose postën) ose një dërgues i njohur (një dërgues i cili e nis ngarkesën ose postën për llogari të vet dhe procedurat e të cilit plotësojnë rregullat dhe standardet e përgjithshme të sigurisë të mjaftueshme për të lejuar transportin e ngarkesës ose postës në çdo avion) dhe përmbush kërkesat e standardeve të përgjithshme bazë mbi sigurinë e aviacionit, kriteret

e përcaktuara në paragrafin 1 konsiderohet se janë plotësuar në lidhje me vendet dhe operacionet për të cilat aplikanti ka fituar statusin e agjentit rregullues ose të agjentit të njohur në masën që kriteret për dhënien e statusit të agjentit rregullues ose të agjentit të njohur, janë të njëjta ose ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 2(e) të këtij aneksi.

Neni 8

Kushtet për pranimin e kërkesës për statusin e OEA-së

1. Përveç kushteve për pranimin e një aplikimi në përgjithësi, për të aplikuar për statusin e OEA-së aplikanti dorëzon një pyetësor vetëvlerësimi, të cilin autoritetet doganore e vënë në dispozicion së bashku me aplikimin.

2. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një aplikim të vetëm për statusin e OEA-së që mbulon të gjitha qendrat e tij të përhershme të biznesit në territorin doganor të një Pale të CEFTA-s.

TITULLI II

PËRFITIMET QË RRJEDHIN NGA STATUSI I OEA-SË QË DO TË JEPET NGA PROGRAMET KOMBËTARE TË OEA-SË NË VENDET E PALËVE TË CEFTA-S

Neni 9

Lehtësirat në lidhje me deklaratat e paranisjes

1. Kur një operator ekonomik i autorizuar për sigurinë, referuar në nenin 1(2b) të këtij aneksi, paraqet në emër të tij një deklaratë të paranisjes në formën e një deklarate doganore ose një deklarate riekspori, nuk kërkohen hollësi të tjera përveç atyre të shprehura në deklaratat të tilla.

2. Kur një OEAS paraqet në emër të një personi tjetër, i cili gjithashtu është OEAS, një deklaratë të paranisjes në formën e një deklarate doganore ose të një deklarate riekspori, nuk kërkohen hollësi të tjera përveç atyre të shprehura në deklaratat të tilla.

Neni 10

Trajtim më i favorshëm në lidhje me vlerësimin e riskut dhe kontrollin

1. Operatori Ekonomik i Autorizuar (OEA) do t'u nënshtrohet më pak kontrolleve fizike dhe atyre dokumentare se operatorët e tjerë ekonomikë.

2. Kur një OEAS ka paraqitur një deklaratë përmbledhëse ose një deklaratë doganore, ose një deklaratë për magazinim të përkohshëm apo kur një OEAS ka paraqitur një njoftim dhe ka dhënë akses në hollësitë që lidhen me deklaratën e tij përmbledhëse të hyrjes në sistemin e tij kompjuterik, zyra doganore e parë, kur ngarkesa është përzgjedhur për kontroll fizik, duhet të njoftojë OEAS-në për këtë fakt. Njoftimi duhet të bëhet para mbërritjes së mallrave në territorin doganor të Palës së CEFTA-s.

Ky njoftim do të vihet, gjithashtu, në dispozicion të transportuesit nëse është i ndryshëm nga OEAS-ja që referohet në nënparagrafin e parë, me kusht që transportuesi të jetë OEAS dhe të jetë i lidhur me sistemet elektronike në lidhje me deklaratat e referuara në nënparagrafin e parë.

Ky njoftim nuk do të jepet nëse rrezikon kontrollin që do të kryhen ose rezultatet e tyre.

3. Kur një OEAS paraqet një deklaratë për magazinim të përkohshëm ose një deklaratë doganore para paraqitjes së mallrave, zyra doganore kompetente për marrjen e deklaratës për magazinim të përkohshëm apo të deklaratës doganore, kur ngarkesa është përzgjedhur për kontroll doganor, duhet të njoftojë OEA-në për këtë fakt. Ky njoftim do të bëhet para paraqitjes së mallrave në doganë.

Ky njoftim nuk do të jepet nëse rrezikon kontrollin që do të kryhen ose rezultatet e tyre.

4. Kur dërgesat e deklaruara nga një OEAS janë përzgjedhur për kontroll fizik ose kontroll dokumentar, këto kontrolle do të kryhen si çështje me përparësi.

Me kërkesën e OEA-së, kontrollet mund të kryhen në një vend të ndryshëm nga ai ku mallrat duhet të paraqiten në doganë.

5. Njoftimet e referuara në paragrafët 2 dhe 3 nuk kanë të bëjnë me kontrollet doganore të vendosura në bazë të deklaratës së magazinimit të përkohshëm ose deklaratës doganore pas paraqitjes së mallrave.

Neni 11

Përfshirja nga trajtimi i favorshëm

Trajtimi më i favorshëm referuar në nenin 9 të këtij aneksi nuk zbatohet për kontrollet doganore që lidhen me nivele të veçanta të ngritura kërcënimi apo detyrimet e kontrollit të përcaktuara në legjislacionin tjetër vendës të një Pale të CEFTA-s.

Megjithatë, autoritetet doganore duhet të kryejnë përpunimin, formalitetet dhe kontrollet e nevojshme për dërgesat e deklaruara nga një OEAS si çështje me përparësi.

TITULLI III

PEZULLIMI, REFUZIMI, REVOKIMI DHE ANULIMI I STATUSIT TË OPERATORIT EKONOMIK TË AUTORIZUAR NË PROGRAMET KOMBËTARE TË OEA-së TË PALËVE TË CEFTA-s

Neni 12

Efektet ligjore të pezullimit

1. Kur një autorizim i OEA-së pezullohet për shkak të mosrespektimit të ndonjë prej kriterëve të referuara në nenin 2 të këtij aneksi, çdo vendim i marrë në lidhje me këtë OEA i cili bazohet në autorizimin e OEA-së në përgjithësi ose në ndonjë prej kriterëve specifike të cilat çuan në pezullimin e autorizimit të OEA-së, autoriteti doganor që ka marrë këtë vendim, e pezullon atë.

2. Pezullimi i një vendimi në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor i marrë për një OEA nuk çon në pezullimin automatik të autorizimit të OEA-së.

3. Kur një vendim në lidhje me një person që është njëkohësisht edhe OEAS, edhe operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësimet doganore, referuar në nenin 1(2a) të këtij aneksi (OEAD), pezullohet në vend të anulimit, revokimit ose ndryshimit kur:

a) Autoriteti doganor konsideron se mund të ketë arsye të mjaftueshme për anulimin, revokimin ose ndryshimin e vendimit, por nuk ka ende të gjitha të gjitha elementet e nevojshme për të vendosur mbi anulimin, revokimin ose ndryshimin;

b) Autoriteti doganor konsideron se nuk janë përmbushur kushtet për vendim ose se OEA-ja nuk vepron në përputhje me detyrimet e vendosura sipas autorizimit të OEA-së dhe është me vend që t'i jepet kohë OEA-së për të marrë masa që sigurojnë përmbushjen e kushteve ose pajtueshmërinë me detyrimet;

c) OEA-ja kërkon një pezullim të tillë sepse nuk është përkohësisht në gjendje për të përmbushur kushtet e përcaktuara për vendimin ose për të plotësuar detyrimet e vendosura përmes këtij vendimi,

për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 2(d) të këtij aneksi, autorizimi i tij i OEAD-së pezullohet, por autorizimi i tij i OEAS-së mbetet i vlefshëm.

Kur një vendim në lidhje me një person që është edhe OEAS, edhe OEAD pezullohet në përputhje me 3(a), 3(b) ose 3(c) për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 2(e) të këtij aneksi, autorizimi i tij i OEAS-së pezullohet, por autorizimi i tij i OEAD-së mbetet i vlefshëm.

Neni 13

Refuzimi i aplikimit

Refuzimi i një aplikimi të OEA-së nuk ndikon në vendimet ekzistuese të favorshme të marra për

aplikantin, në përputhje me legjislacionin doganor, përveç rasteve kur dhënia e këtyre vendimeve të favorshme bazohet në përmbushjen e ndonjë prej kriterëve të OEA-së që janë vërtetuar se nuk janë plotësuar gjatë shqyrtimit të aplikimit të OEA-së.

Neni 14

Revokimi i autorizimit

1. Revokimi i autorizimit të OEA-së nuk cenon asnjë vendim të favorshëm që është ndërmarrë në lidhje me të njëjtin person, përveç kur statusi i OEA-së ishte kusht për këtë vendim të favorshëm ose, kur ky vendim është bazuar në një kriter të renditur në nenin 2 të këtij aneksi i cili nuk plotësohet më.

2. Revokimi ose ndryshimi i një vendimi të favorshëm që është marrë në lidhje me mbajtësin e autorizimit nuk ndikon automatikisht në autorizimin e OEA-së të këtij personi.

3. Kur i njëjti person është njëkohësisht OEAD dhe OEAS zbatohet për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 2(d) të këtij aneksi, autorizimi i OEAD-së revokohet dhe autorizimi i OEAS-së mbetet i vlefshëm.

Kur i njëjti person është njëkohësisht OEAS dhe OEAD, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 2(e) të këtij aneksi, autorizimi i OEAS-së revokohet dhe autorizimi i OEAD-së mbetet i vlefshëm.

Neni 15

Anulimi

1. Autoritetet doganore anulojnë autorizimin e OEA-së nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Vendimi për autorizimin e OEA-së është marrë mbi bazën e informacioneve të pasakta dhe të paplota;

b) OEA-ja kishte dijeni ose duhej të ishte në dijeni se informacioni ishte i pasaktë ose i paplotë;

c) Nëse informacioni do të ishte i saktë dhe i plotë, vendimi për autorizimin e OEA-së do të ishte ndryshe.

2. OEA-ja duhet të njoftohet për anulimin e tij.

3. Anulimi do të ketë efekt nga data e hyrjes në fuqi të vendimit fillestar, përveç nëse specifikohet ndryshe në autorizimin e OEA-së, në përputhje me legjislacionin doganor.